REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

| | |
|---|---|
| **Për/To/Za :** | **Komitetin për Politikë dhe Financa** |
| **Nga/From/Od :** | **Drejtoria për Financa,Ekonomi dhe Zhvillim - z. Enver Berisha** |
| **Përmes/Through/Preko :** | **z. Zenun Elezaj – Kryetar i KK- Klinë** |
| **Tema/Subjekt/Subjekat:** | **Kërkesë për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025** |
| **Data :** | **28.03.2025** |

**Të nderuar,**

Duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025 , kërkojmë bartjen e mjeteve te pashpenzuara dhe mjetet nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024, dhe bartjen në vitin 2025, gjithsej shumën prej **624,854.99 €.**
Nga shuma e përgjithshme **624,854.99 €,** nga fondi 21 dhe 22 është shuma prej 293,727.28 € dhe nga tejkalimi i planifikimit të të hyrave shuma prej **331,127.71 €.** Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave Ligjit te buxhetit për vitin 2025 dhe Ligjit te Menaxhimit te Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet nga viti paraprak sipas kontratave të nënshkruara. Nisur nga kjo propozimi ynë për shpërndarjen e tyre nëpër programet dhe nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, është si vijon:

- Mallra dhe Shërbime në shumën prej **90,000.00 €;**
- Shpenzimet komunale në shumën prej **90,000.00 €;**
- Subvencione dhe transfere shumën prej **92,746.95 €.**
- Shpenzime kapitale në shumën prej **352,108.04 €;**

**Nga bartja e mjeteve të pashpenzuara, shuma 293,727.28 €.**

**<u>Në kategorinë mallra dhe shërbime :</u>**
**Arsimi Parafillor (92550),** shuma prej **7,619.50 €;**
**Arsimi Mesëm (94710),** shuma prej **11,936.30 €;**
**Buxhetimi (17518),** shuma prej **279.23 €;**

**<u>Arsyetimi:</u>** Bartja e të hyrave në shumën prej 19,835.03 €, në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime bëhet për arsye të pagesës së obligimeve dhe shpenzimeve të krijuara për zhvillimin e veprimtarisë deri në fund të vitit 2025.

**<u>Në kategorinë e shpenzimeve komunale :</u>**
**Drejtoria për Buxhet e Financa (17518),** shuma prej **108.47 €;**

**Arsyetimi:** Bartja e të hyrave në shumën prej 108.47 €, në kategorinë ekonomike shpenzime komunale bëhet për arsye të pagesës së obligimeve të pa shlyera gjatë vitit 2024 dhe rritjes së shpenzimeve për rrjetin e ndriqimit publik dhe nxemjet qendrore me pompa termike me energji elektrike.

**Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve**
**Zyra e Kryetarit** (16018) shuma prej **3,520.97;**
**Administrata e arsimit** (92090) shuma prej **2,800.00 €;**

**Arsyetimi:** Bartja e të hyrave në shumën prej 6,320.97 €, në kategorinë e shpenzimeve - subvencione dhe transfere bëhet për mbulimin e obligimeve dhe shpenzimeve të krijuara për arsye të rritjes së kërkesave për raste shëndetsore, shpenzime për lindje, varrime.

**Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:**
**Planifikimi urban dhe inspeksion (66395 ), në projektet:**
"Ndertimi i infrastruktures nentoksore dhe mbitoksore ne Siqeve-Ujmire-Shtarice", kodi (54924), shuma prej 20,000.00 €;
"Ndertimi i infrastruktures nentoksore dhe mbitoksore ne Poterq-Dugajeve-Drenovc", kodi (54344), shuma prej 25,000.00 €;
"Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj", kodi (56059) shuma prej 20,000.00 €;
"Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj", kodi (56063), shuma prej 20,000.00 €;
"Ndertimi i infrastruktures mbitoksore(Trotuare) dhe infrastrtuktures nentokesore ne Zajm-Deiq", kodi (56074), shuma prej 15,000.00 €;
"Ndertimi i infrastruktures mbitokesore dhe infrastruktures nentokesore Volljake-Sferke-Qupeve-Dush", kodi (56084), shuma prej 15,000.00 €;
"Ndertimi i infrastruktures mbitokesore dhe infrastrtuktures nentokesore Gjurgjevik i madh-Dush", kodi (56094), shuma prej 25,000.00 €;
"Ndertimi i infrastruktures mbitokesore dhe nentokesore ne Jashanice-Jelloc-Resnik", kodi (56106), shuma prej 21,000.00 €.
**Bujqësi (47018), në projektet:**
"Ndërtimi i kanaleve te ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë- Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj", kodi (56152), shuma prej 44,698.91 €.
**Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:**
"Rindertimi i infrastruktures mbitokesore me asfalt ne Jashanice,Shtupel,Zllakuqan,Kline-Videje etj", kodi (56126), shuma prej 45,986.30 €;
**Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), në projektet:**
"Ndertimi dhe rindertimi I objekteve shendetesore: QKMF, AMF Drenoc, Ujmire, Zllakuqan dhe Gllareve etj", kodi (56149), shuma prej 150.00 €.
**Arsim dhe Shkencë - Administrata (92090), në projektet:**
"Ndertimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kaldaja me pelet ne shkolla në Gjimnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik I Madh, Budisalc, Ujmirë, Dren (56137), shuma prej 10,000.00 €;
"Ndërtimi I fushave sportive dhe parkingjeve në shkolla në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj", kodi (56147), shuma prej 5,627.60 €.

**Arsyetimi:** Bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale në shumën prej 267,462.81 €, bëhet për mbulimin e obligimeve kontraktuale dhe vazhdimin e projekteve të pa përfunduara.

**Rritja nga tejkalimi i planifikimit të të hyrave gjatë vitit 2024, shuma prej 331,127.71 €**

**Në kategorinë mallra dhe shërbime :**
**Buxhetimi (17518),** shuma prej **57,164.97 €;**
**Administrata (16318),** shuma prej **5,000.00 €;**
**Shërbimet Kulturore (85018),** shuma prej **8,000.00 €;**

**Arsyetimi:** Bartja e të hyrave në shumën prej 70,164.97 €, në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime bëhet për arsye të pagesës së obligimeve dhe shpenzimeve të krijuara për zhvillimin e veprimtarisë deri në fund të vitit 2025 (pagesën e Këshillave të fshatrave, pagesën për Komitetit për komunitete të anëtarëve që nuk janë në lista të rergullta të pagave, pagesën e anëtarëve të KKSB) .

**Në kategorinë e shpenzimeve komunale :**
**Buxhetimi (17518),** shuma prej **49,891.53 €;**
**Administrata (92090),** shuma prej **40,000.00 €;**

**Arsyetimi:** Bartja e të hyrave në shumën prej 89,891.53 €, në kategorinë ekonomike shpenzime komunale bëhet për arsye të pagesës së obligimeve të pa shlyera gjatë vitit 2024 dhe rritjes së shpenzimeve për rrjetin e ndriqimit publik dhe nxemjet qendrore me pompa termike me energji elektrike.

**Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve**
**Zyra e Kryetarit** (16018) shuma prej **16,479.03;**
**Shërbimet Kulturore (85018),** shuma prej **69,946.95 €;**

**Arsyetimi:** Bartja e të hyrave në shumën prej 86,425.98 €, në kategorinë e shpenzimeve - subvencione dhe transfere bëhet për mbulimin e obligimeve dhe shpenzimeve të krijuara në mungesë të buxhetit për arsye të pëmbarimeve ne muajin mars 2025.

**Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:**
**Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:**
“Rindertimi i infrastruktures mbitokesore me asfalt ne Jashanice,Shtupel,Zllakuqan,Kline-Videje etj”, kodi (56126), shuma prej 4,013.70 €;

**Shërbimet Rezidenciale (75587), në projektet:**
“Ndertimi i shtepise se pleqeve ne Kline”, kodi (54463), shuma prej **15,000.00** €.
**Administrata (16318), në projektet:**
“Blerja e veturave zyrtare per nevoja te Administrates Komunale”, kodi (54370), shuma prej **22,290.00** €
**Shërbimet Kulturore (85018), në projektet:**
“Ndertimi dhe Rindertimi i Objektit Sportiv dhe te Kultures ne Kline”, kodi (56154), shuma prej **38,969.13** €
**Arsim dhe Shkencë - Administrata (92090), në projektet:**
“Ndërtimi I fushave sportive dhe parkingjeve në shkolla në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj”, kodi (56147), shuma prej **4,372.40** €.

**Arsyetimi:** Bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale në shumën prej 84,645.23 €, bëhet për mbulimin e obligimeve kontraktuale dhe vazhdimin e projekteve të pa përfunduara, edhe për shkak të përmbarimeve në muajin mars 2025.

**Komuna e Klinës**

**Kuvendi i Komunës**

**01Nr.________________2025**

**Klinë**

**PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 21. 03. 2025, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.**

***Pjesëmarrës në mbledhje, kryetari I komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja e komunës, znj. Marqe Selmanaj, drejtorët e drejtorive, Policia e Kosovës, anëtarët e kuvendit, mediat lokale, qytetarë.***

Mbledhjen e hapi kryesuesi I kuvendit, z. Fadil Gashi I cili përshëndeti gjithë të pranishmit dhe konstatoi se prezent janë 23 anëtarë të kuvendit.

Rreth Rendit të ditës kryesuesi tha se ka një propozim që me kërkesë të drejtorisë pika 9 të hiqet. Po ashtu propozoj që të vendoset një pikë e re zëvendësim posa ardhur nga ministria e PH që është rishqyrtimi I vendimit për vënien në diskutim publik të planit zhvillimor komunal 2025-2033.

Hapet debat për rendin e ditës.

**Pasi që nuk kishte askush për të diskutuar për rendin e ditës kryesuesi e vuri në votim dhe me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi I mungesave: Mungon Zafer Gashi, Kushtrim Haliti, Ilir Hoti**

**Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi I procesverbali i mbledhjes së kaluar**

**Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I KPF-së.**

**Në bllok me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 4 e Rendit të Ditës: Rishqyrtimi I vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake në paga dhe mëditje.**

Kjo pikë lidhet edhe me pikën 5 që është me pagesën e shujtave tha kryesuesi. Ai tha se këtë seancë po e rishqyrtojmë dhe në seancën e radhës të vijë e harmonizuar për bartjen e mjeteve. Kjo kërkesë është nga ministria sikurse tha kryesuesi. Ai tha se në seancën e radhës drejtoria të na I sjellë të dy shkresat bashkë.

**Me 24 vota u MIRATUA rishqyrtimi**

**Pika 5 e Rendit të Ditës: rishqyrtimi i vendimit për pagesën e shujtave.**

Kryesuesi tha se për këtë çështje kemi qenë edhe në takim në ministri, Sot na kanë dërguar edhe një shkresë ku sipas tyre vendimi i kuvendit i marrë është i pazbatueshëm. Kryesuesi tha se ne kemi disa alternativa: Ta rishqyrtojmë, Ta anulojmë ose të mbesim pranë vendimit tonë ku më pastaj ministria ka të drejtë të na padisë dhe këtë pastaj e vendosë gjykata. Ndoshta kjo e fundit është më e drejta, tha kryesuesi.

**z. Valmir Bacaj:** përshëndetje të gjithëve! Ne si grup kuvendar jemi që ta shqyrtojmë sipas kërkesës por të qëndrojmë pranë vendimit që kemi marrë.

**z. Esat Raci:** Përshëndetje të gjithëve. Edhe ne e përkrahim kërkesën për pagesën për shujta për shërbyesit civil. Kemi disa dilema edhe pyetje: Sipas informative që kam për vitin 2021 janë paguar shujtat por për vitin 2022 dhe 2023 nuk janë paguar. A kemi raste të njëjta ku paguhen shujta në komuna të tjera. Sipas mendimit tim ekzekutivi nuk e ka pasur vullnetin që të paguhen këto shujta.

Kryesuesi tha se ka komuna që I kanë paguar shujtat. Ai tha se ne nuk e kemi prekur vendimin bazë për ndarjen e shujtave I cili vendim edhe sot është në web të komunës, Ne e kemi ndryshuar vetëm vlerën nga 2. 5 euro për shujtë .

**z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje të gjithëve. Më habit fakti pse ministria bënë këso dallimesh- një komunë ja lejon një komunë tjetër nuk ja lejon. Ne e dimë që pagat e punëtorëve në komunë janë minimale. Unë pajtohem me mendimin e Valmirit dhe të qëndrojmë parapa vendimit tonë.

**z. Arben Limanaj:** Përshëndetje. Edhe ne si grup jemi që të mbështesim punëtorët që të marrin shujtat. Si grup mendojmë që këtë çështje ta definojmë përmes gjykatës.

**z. Enver Berisha, drejtor I FEZH**: Përshëndetje. Kam obligim dy sqarime të shkurta. Ne bashkë me kryetarin e kemi nënshkruar vendimin për shujta por lënda ka shkuar në gjykatë dhe gjykata ka vendosur në tre mënyra. Një pjesë ka shkuar në rishqyrtim, një pjesë është aprovuar dhe një pjesë është refuzuar. Ne si ekzekutiv e kemi kryer punën tonë. Ne dje e kemi dërguar një delegacion në ministri që ta sqarojnë vendimin që ata e kanë dërguar për mospagesë të shujtave por nuk kanë gjetur mirëkuptim. Hapat ne si komunë që është dashur që të i marrim, i kemi marrë gjithsesi.

**z. Esat Raci:** Drejtor, pse në 2020 dhe 2021 janë paguar shujtat.

**z. Enver Berisha, drejtor I FEZH:** Kjo ka qenë si rezultat I kontratës kolektive. Gjykatat edhe për ato vite ka marr tre vendime të ndryshme, nuk është çështje e jona.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Ne, vazhdimisht e kemi dërguar kërkesën për pagesë të kompletuar por me ardhjen e qeverisë Kurti nuk na janë lejuar që të i paguajmë. Kjo e fundit që morëm vendim në seancën e fundit, na kanë thënë që nuk I kemi mjetet në kategori edhe pse ne i kemi. Ne prap i dërgojmë qe të i paguajmë por nuk na i ekzekuton thesari.

Kryesuesi tha se po vendosim që ne të mbesim pranë vendimit të marrë nga ky kuvend në seancën e kaluar.

**Me 24 vota për , asnjë abstenim dhe asnjë kundër u MIRATUA**

**Pika 6 e Rendit ët Ditës: Rishqyrtimi i planit lokal të veprimit në mjedis**

**z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizimit:** Përshëndetje. Rekomandimet I kemi përmirësuar sipas kërkesës së ministrisë dhe tani ky planë është I gatshëm për votim.

**Me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 7 e Rendit të Ditës: Rishqyrtimi I rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale në komunën e Klinës.**

**z. Nikson Dakaj, drejtor I Kadastrit**: Ndryshimet e kërkuara janë bërë dhe rregullorja është e gatshme.

**Me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 8 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozim vendimit nga drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale për ndërrimin e titullarit të pronave sipas propozimit nga drejtoria e shëndetësisë.**

**z. Agron Bacaj, drejtor I Shëndetësisë:** Siç jeni të informuar nga plani I punës, drejtoria e shëndetësisë ka planifikuar për ndërrim të titullarit të disa pronave që janë afër shtëpisë për përkujdesje shëndetësore të moshuarve. Aty kemi planifikuar të ndërtimit të emergjencës dhe objektin e mjekësisë familjare. Sot në një formë na është konfirmuar edhe donacioni prandaj kërkoj nga ju që të votoni ndërrimin e titullarit. Pronat që janë të evidentuara si pronë e shkollës të kalojnë në pronë të komunës.

**Me 24 vota për, asnjë abstenim dhe asnjë kundër U MIRTUA**

**Pika 9 e Rendit ët Ditës: rishqyrtimi I vendimit për vënie në diskutim publik të planit zhvillimor komunal 2025-2033**

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Ne e kemi nisur moti këtë procedurë dhe unë I kam 4 shkresa të ministrisë së njëjtë dhe zyrtarëve të njëjtë. Shkresa e parë: Me konstatim dhe aprovim zyrtar të ministrisë së mjedisit dhe PH I propozojnë kuvendit ët komunës që të marrin vendim për lëshuare në diskutim publik,(pason  data). Ne, bazuar në këtë kemi marrë vendim. Pasi e kemi marr vendimin ka ardhur shkresa nga ministria e njëjtë

ku thotë që anulohet vendimi I Kuvendit. Prapë na ka ardhur shkresë tjetër ku njëjtë thuhet si në të paren nga të njëjtit zyrtar dhe ne në seancën e shkurtit kemi marrë vendim bazuar në atë shkresë. Por prap vjen shkresë tjetër ku kërkon rishqyrtim të vendimit të marrë. Tani ne nuk e dimë se me cilin akt të tyre duhet të punojmë. Janë të njëjtit zyrtar që kanë nënshkruar. Pyetje: A më të drejt kanë bizneset private që shkojnë dhe intervenojnë atje apo kuvendi I komunës. Kjo punë e ka humbur seriozitetin derisa ata vet nuk mund të harmonizohen me aktet e veta, si të harmonizojmë ne këtu. Ne prap po e rishqyrtojmë sipas kërkesës por e ka humb seriozitetin dhe neve si kuvend pa fajin tonë po na qet jo mirë.

Kryesuesi tha se nuk e ka më të qartë se a duhet të anulohet apo të rishqyrtohet. Ai kërkoj mendim edhe nga kryetari

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Pajtohem plotësisht me kryesuesin  por është një gabim teknik në preambulë. Çështjet ligjore janë çështje ligjore, ne e kemi obligim që ta rishqyrtojmë. Duhet të plotësohet ai gabim teknik dhe prap ta sjellim për ta vënë në debat publik. Ne po e marrim vendimin me e leshu në debat publik me plotësimin e atij gabimi teknik.

**z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizimit:** Pajtohem me kryetarin. Ka qenë një gabim teknik dhe nuk është dashtë që të kthehet për rishqyrtim.

Kryesuesi tha se po e them hapur që ata nga ministria ose kanë hyrë në garë me bizneset ose kanë inati me komunën e Klinës sepse nuk kthehet dokumenti për një pik e një presje.

z. Valmir Bacaj propozoj që të merret vendim për ta venë në diskutim publik me plotësimin e preambulës.

**z. Esat Raci:** Do të thoja që të bëhet një konsultë me zyrën ligjore dhe të mos bëhen shkelje të vogla të tilla.

**z. Driton Raci, zyra ligjore:** Përshëndetje. Lidhur me kërkesën e tillë ne si zyre nuk e kemi parë se nuk na ka ardhë nga drejtoria po ashtu nuk e kemi parë shkresën e ministrisë. Nëse nga ministria kanë kërkuar që të rishqyrtohet, duhet që të rishqyrtohet.

**Sipas kërkesës për rishqyrtim, vendimi u rishqyrtuar dhe u lëshua në votim dhe me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA**

**Pika 10 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi I raportit nga procesi I organizimit të konsultimit publik për rregulloren për transparencë dhe planin e veprimit për transparencë komunale.**

**Znj. Vlora Tafilaj, zyra për informim:** Përshëndetje. Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna si dhe Statutin e Komunës, po shpalos para jush Draft-Rregulloren për Transparencë të Komunës së Klinës.

Kjo Rregullore përcakton rregullat që sigurojnë transparencë të punës së organeve komunale, kryetarit të komunës, drejtorive, kuvendit, trupave të kuvendit si dhe mekanizmave të tjerë ligjor, si dhe rregullat, parimet dhe format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha organet e komunës që ushtrojnë autorizime publike sipas ligjit, duke filluar nga ju së pari si kuvend;

Transparenca e Kuvendit -Përbëhet nga disa nene; transmetimi i seancave, Informimi për mbledhjet e kuvendit dhe komiteteve, Përdorimi dhe mirëmbajtja e sistemit të Teleprezencës etj.

Dhe secili nga këto nene ka dispozita se si të sigurohet një organizim i mirëfilltë i procedurave dhe respektim i afateve e me ç` rast arrihet një nivel transparencë të punës së Kuvendit. Nuk isha ndal në shembuj shumë sepse ju si anëtarë të kuvendi jeni të njoftuar dhe keni njohur rreth këtyre dispozitave ligjore pasi ju jeni ata që përballeni me shumë me to në aspektin e punës dhe angazhimit. Tek transparenca e ekzekutivit:

1. Kryetari i komunës ofron transparencë për procesin vendimmarrës të tij, drejtorive dhe administratës.

2. Kryetari i komunës është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në publikim të akteve të ekzekutivit, dhe dokumenteve zyrtare në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-82 për mbrojtën e të dhënave personale dhe Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike si dhe dispozita te tjera. Si Zyre tani kemi web faqen e re zyrtare dhe publikimi i këtyre akteve është në nivelin më të mirë të mundshëm këtë e konstatojnë shumë monitorime dhe vlerësime që nga Raporti i Përformances Komunale, KDI, GAP është renditur si komuna e dytë nga 38 komunat, për nivelin e transparencës komunale me 93 pikë nga 96 të mundshme apo 96.88%, performancë të shkëlqyer në sigurimin e transparencës dhe mbështetjen e hapësirës së informimit për qytetarët. Nëse ju si kuvend, e shihni të arsyeshme që për hir të transparencës sonë të përbashkët, që një dokument të publikohet në vazhdimësi dhe që mendoni që i mungon web faqes zyrtare mund ti jepni propozimet e juaj dhe të fillojmë ta shqyrtojmë si mundësi dhe ta krijojmë si praktikë që ta publikojmë. Në pjesën e fundit janë QASJA NË DOKUMENTET PUBLIKE, INFORMATAT PËR SHËRBIME DHE KOMUNIKIMI, Respektimi i gjuhëve zyrtare, si dhe Funksionimi i faqes zyrtare elektronike të Komunës. Me këtë rast, po ndalem edhe njëherë, ju si kuvend nëse keni ndonjë sugjerim apo ide se tani në formatin e një departamenti apo cili dikasteri apo procedurë tjetër që duhet të përfshihet në rregullore e diskutojmë prap së bashku.

Krejt në fund kjo rregullore shfuqizon rregulloren e vjetër për Transparencë, e datës 26.12.2014, me numër protokolli; 01 Nr. 031-5713/2014.

**Rregullorja për transparencë e komunës së Klinës u vu në votim dhe me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 11 e rendit të Ditës: Plani I veprimit për transparencë**

**Me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRTUA**

**Pika 12 e Rendit ët Ditës: Informatë për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror- informatë nga drejtoria e SHPE**

**z. Qendrim Millaku, drejtor I SHP:** Përshëndetje të gjithëve. Drejtoria e SHP në kuadër të kontratës ka realizuar me sukses mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror. Gjatë kësaj sezone janë mirëmbajttë rreth 160 km rrugë. Pastrimi I borës dhe hapja e rrugëve ka qenë e rëndësishme për qytetarët e komunës sonë.

z. Millaku specifikoj në detaje të gjitha rrugët e fshatrave se ku është vepruar gjatë sezonit të dimrit.

**Pika 13 e rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje**

**Znj. Besiana Gashi:** Përshëndetje. Po e paraqes një shqetësim të qytetarëve lidhur me drejtorinë e shëndetësisë. Drejtor a jeni në dijeni se qytetarët janë të obliguar që të blejnë sistemet e infuzioneve edhe pse raftet e QKMF janë të mbushur me ta, po ashtu mungesa e higjienës në QKMF. A keni inspektuar se si po trajnohen praktikantet shumë herë kryejnë shërbime pa prezencën e mentorëve.

**z. Agron Bacaj, drejtor I Shëndetësisë:** Nuk besoj që praktikantët mund të japin shërbime pa prezencën e mjekut ndërsa sa I përket higjienës është ashtu siç e the ti, kemi marrë masa por fluksi I pacientëve është I madh. Kemi angazhuar shtesë punëtorë për pastrimin e atyre hapësirave. Mungesa e sistemeve mund të them me përgjegjësi se QKMF është e pajisur me artikuj elementar. Sigurisht që këtë problem e kam trajtuar edhe në komitetin ku ju jeni kryesuese. Ne ballafaqohemi me mungesa shkaku I një vendimi që ka marrë ministri së fundmi. Edhe në barnatore private mungojnë sasi e barnave etj. shkaku I atij vendimi. Ne jemi në konsulta të përditshme me ministrinë dhe jemi duke bërë kërkesa të vazhdueshme. Nuk besoj që raftet janë të mbushura me sisteme, nuk po e përjashtoj ndonjë rast të shkeljeve por ne kemi monitorimin , vend për përmirësime ka dhe jemi të gatshëm që ta bëjmë atë.

**Znj. Besiana Gashi:** Faleminderit për informacionet por nuk pajtohem me atë që e the. Të shtunën jam detyruar vet që të blej sistemet dhe kam edhe fotografi që sisteme ka pasur në dollap.

**z. Agron Bacaj, drejtor I shëndetësisë:** Kërkoj nga ju Besiana që ta thoni emrin e mjekut dhe teknikut që të shtunën ka qenë në ndërrim dhe me e faktuar gjendjen që sistemet kanë qenë në vitrine dhe mjeku apo tekniku nuk ti ka ofruar. Menaxhmenti I QKMF do të merr masa.

**Znj. Besiana Gashi:** Unë personalisht nuk kam marrë shërbim por nëna e ime dhe unë I kam pyetur se a keni mungesë të sistemeve dhe më kanë thënë që po. Ndërkohë që nuk ka pasur mungesë të tyre. Ju I keni evidencat se kush ka qenë në ndërrim në atë kohë dhe datë. Unë kam pyet edhe ata që kanë marr infuzione dhe më kanë thënë që

vazhdimisht blejnë vet sistemet e tilla dhe atë pacient që ka pasur 7 ditë të javës që I ka ble vet.

**z. Agron Bacaj, drejtor:** Nuk e përjashtoj mundësinë që të ketë mungesë fjala për sisteme të tilla por e mohoj kategorisht që të ketë sisteme aty dhe të mos I epet pacientit.

**Znj. Blerina Berisha-Gashi:** Edhe unë dua të ndërlidhem tek shëndetësia dhe të shpreh shqetësimin tim. Para disa ditëve isha në QKMF për vaksinimin e foshnjës sime 8 muajsh, Kam pritur një orë e gjysmë dhe pediatri nuk ishte aty , jam detyruar që ta bëjë kontrollin para vaksinimit tek mjeku i përgjithshëm. Dua ta pyes drejtorin se stafi a e merr pushimin qysh duan ata apo qysh jua keni përcaktuar ju me rregullore. Po ashtu kam një kërkesë të përsëritur për drejtorin e urbanizimit për rregullimin e një rruge në Qupevë , lagja Fazlia. A është në plan në këtë vit të rregullohet.

**z. Agron Bacaj, drejtor I shëndetësisë:** Mjekët pediatër punojnë nga ora 7 deri në 15 përjashtim në kohën e pauzës nga ora 11 deri në 12. Ata zëvendësohen nga mjakët e përgjithshëm. Përndryshe ata janë gjithmonë aty në punë në këtë orar.

**z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit:** Nuk besoj që kam thënë se do të kryhet këtë vit por kur të kemi mundësi buxhetore. Ajo rrugë është rrugë private dhe mendoj që duhet të kthehet në rrugë publike. Sigurisht që do të rregullohet por mos e merr gjithmonë strikt këtë vit me ke thënë dhe u krye sepse ka shumë rrugë të pashtruara.

**Znj. Blerina Berisha-Gashi:** Kur bënë që të emërtohet rruga e nuk bënë që të asfaltohet, nuk e kuptoj. Mos të flasim për rrugë private sepse ka plotë rrugë private që i keni shtruar deri në derë të shtëpisë

**z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit:** Prandaj jemi ne që të shtrojmë rrugë njerëzve

**znj. Blerina Berisha-Gashi:** E ne a jemi njerëz?

**z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit:** Mendoj që të gjithëve ju kemi kërkuar pëlqimin e kemi praktikuar këtë që të jua marrim pëlqimin dhe besoj që këtë vit edhe rruga e juaj do të asfaltohet.

(Gjatë seancës u bashkua edhe Kushtrim Haliti dhe Zafer Gashi)

**z. Esat Raci:** Që 4 ose 5 vite, zyra e ofiqarisë në Ujmir nuk ka zyrtar. Pse? Për atë pozitë janë pranuar disa zyrtar por si duket janë të pa dëgjueshëm dhe nuk po shkojnë që të punojnë aty.

**Z. Binak Sylaj, drejtor i administratës:** Pyetje që më ke pyetur edhe një herë dhe vazhdon të jetë përgjigja e njëjtë. Jemi në rrugë të drejt për të zgjedhur atë problem, Kemi një rekrutim që është me ankesë por që shumë shpejt do të definohet. Shërbimet qytetarët janë duke I marrë dhe nuk kanë asnjë mungesë apo vështirësi. Nuk ka asnjë ankesë nga asnjë qytetar. Reformat kanë mundësuar që qytetari të merr shërbimet pavarësisht nga është, aty ku e ka më së afërmi.

**z. Esat Raci:** Dua që të ja bëjë me dije drejtorit se personalisht dy qytetarë më kanë paraqit shqetësim po ti them me emër: Fatos Milllaku dhe Enver Millaku. Kërkesë e tyre dhe e shumë qytetarëve të tjerë është që zyra në Ujmir të funksionoj. Unë pyeta për punëtorë se a janë pranuar dhe se janë të padëgjueshëm.

**z. Binak Sylaj, drejtor:** Nuk kam informata të tilla, kam një shef të zyrës civile që ai i menaxhon por nuk kam ankesa apo shqetësime. Përndryshe çdo punëtor që pranohet për të punuar aty, do të shkoj aty.

**z. Asdren Ramadani**: Përshëndetje. Në zonën ku unë banoj, ndriçimi pothuajse në 90% është kryer por në atë 10% jam edhe unë d.m.th. në atë 10% banoj unë, në lagjen Rastoka. Kur do ta përfundoni edhe atë pjesë.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Procedurat e prokurimit do të fillojnë javën që vjen. Nuk guxojmë që të shpallim procedura pa përfunduar protokollimi I marrëveshjeve me ministritë që kemi nënshkruar. Këtë vit do ta marrin formën të gjitha punimet por nuk mund të përfundojnë të gjitha, ato do të vazhdojnë edhe vitin tjetër.

**z. Arben Limanaj:** Unë kam një pyetje për drejtorin e urbanizmit. Para një kohe kam parë në rrejtët sociale një banorë të fshatit të Shtaricës ku ai shprehte shqetësim për një urë e cila sipas tij ka shkaktuar edhe vërshimet. Dëshiroj të pyes se a është evituar ai problem. Po ashtu lidhur me kanalizimin që bije mbi këtë fshat a ka përfunduar sepse shqetësimi i banorëve është se ujërat e zeza jua vërshojnë arat.

**z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit :** Nuk ka qenë urë por një beton për çka ne kemi marrë masat dhe e kemi hequr. E kemi zhvendosur kanalizimin dhe është funksional. Edhe lumen e kemi zgjeruar dhe është funksional.

**z. Arben Limanaj:** më vjen mirë që paskeni vepruar shpejt sepse deri tash çdo shqetësim që kam shprehur këtu nuk është vepruar fare.

**z. Ndrec Zefaj:** Dua të pyes edhe unë drejtorin e urbanizimit për trotuarin që ka nisë nga Zllakuqani për në Ranoc e Leskoc, deri ku do të vazhdoj ky trotuar sepse ka zëra që do të ndërprerët deri tek lagja Leshaj. Dhe a do të përfshij ky Projekt edhe ndriçimin publik?

**z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit:** Kur të përfundon trotuari do të përfshij edhe ndriçimin. Kur të përfundoj ky projekt do të vazhdojmë me tjetrin ku do të përfshihen edhe lagjet e tjera.

**z. Ndrec Zefaj:** Do të duhej ta thoni më më zë se ky projekt do të vazhdoj deri tek lagja Leshaj që ta dinë qytetarët.

**z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit:** Për detaje mund të vini në zyre dhe ta shpjegoj në detaje.

**z. Ndrec Zefaj:** Mendoj qe s`ka nevojë që të vijë në zyre , këtë duhet ta thoni këtu sepse votat I keni marrë që të ju dëgjojnë qytetarët.

**z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit:** Ky është një projekt ku në kuadër të tij ka rrugë, kanalizime dhe trotuare, për me qenë I saktë them që të vish dhe ti shikojmë letrat nuk kam asnjë tendencë.

**z. Zafer Gashi:** Do të doja ta pyes kryetarin. A janë ndreq valvulet e fabrikës, shkoj edhe ky muaj. A jemi duke pirë ujë të pijshëm? Ju keni dhënë disa ditë e javë, a e keni dhënë 10% disa punë kryerësve për punë shtesë? Pyetja e dytë: jemi dëshmitarë të një ndotje të madhe që po bëhet nga gurëthyesit, është thënë se ka kontrolla për përdorimin e filtrave etj. Kush udhëton për Prishtinë e sheh në çfarë gjendje është ajo pjesë. Pyetja e tretë: A po i përcjellni këto ndërtimet e larta që keni dhënë leje në qytet dhe pse njërit prej tyre ja keni pezulluar lejen dhe më pastaj ja keni vazhduar?

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Lidhur me fundërruesin, parimisht kompania e ka afatin deri në fund të këtij muaji që ta kryej. Punë shtesë ka por të gjitha procedurat janë të publikuara. Ndotja nga gurthyesit është kompetencë komplet e KPMM. Ndërtimet e larta nuk e dijë nëse ke diçka mund të ju drejtohesh drejtorisë së urbanizimit sepse këta kanë përgjegjësi dhe kompetenca.

**z. Zafer Gashi:** Informatat i keni edhe ju sidoqoftë. Ju po e pranoni që ka punë shtesë edhe pse ju keni premtuar që s` ka me pas më punë shtesë . Sa për ujin e pijshëm keni thënë që në tetor të vitit të kaluar do të lëshohet por nuk u bë akoma.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Puna shtesë është legale dhe unë nuk mund ta ndali, është ligjore. Kemi punë shtesë por janë të vogla.

**z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit**: Ne jemi një ekip që menaxhojmë. Jemi në fazën e testimit të ujit dhe fundërruesit. Kanë hasur në një problem të vogël që firma projektuese e ka bërë dhe kemi bërë përmirësime. Projekti ka përfunduar komplet por më mirë është që mos të ngutemi dhe të bëjmë testimet e duhura. Sa i përket Ndërtimeve në qytet , mund të keni qasje në çdo dokument, ne veprojmë me ligj.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Në lidhje me reparacionet është bërë e padurueshme. Ndotja e ambientin është e theksuar, asnjë nga operatorët nuk I respekton ligjet. Ndoshta është mirë që të i drejtohemi me ndonjë shkresë edhe nivelit qendror që të vijnë e të shohin gjendjen në teren. Kemi edhe vendimin e dytë kur e kemi nxjerrë për fabrikën e çimentos ku kemi kërkuar që Brenda 6-të muajve edhe gurthyesit që të përdorin filtrat gjate separacionit.

**z. Zafer Gashi:** Edhe në fjalën e kryetarit u pa tendenca që të fajësohet qendra. Por operatorët kanë marrë leje edhe nga komuna. Si është e mundur që një inspektor i yni nuk lajmëron qendrën për gjithë atë ndotje që po ndodhë.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Po e shoh që Zaferi po mundohet që të na e lë fajin neve> Komisioni për minerare është kompetent për leje etj. Çdo kompani kur aplikon për leje për gurthyes , ai e bënë projektin ku shpjegon se si do ta trajtoj minimizimin e pluhurit. Ne mund të bëjmë një shkresë apo çfarëdo qoftë por kompetencë është plotësisht e tyre.

Lidhur me këtë çështje debate mes z. Zafer Gashi dhe kryetarit të komunës vazhdoj tutje duke u pajtuar plotësisht se shqetësimi është me vend. U propozua që të ketë një pikë të rendit të ditës në seancën e radhës , propozim i kryetarit. Më pastaj me një kërkesë nga kuvendi të i drejtohen KPMM.

**z. Tunë Dedaj:** Dua të them se a e dini kur ndalet pluhuri? Atë ditë që të përfundoj autostrada. Është e pamundur që të ndalet pluhuri derisa punohet në rrugë.

Për seancën e radhës mbeti që të diskutohet kjo çështje.

**Z. Kushtrim Haliti:** Kam bërë foto të shtyllave të ndriçimit në rrugën për Shtupel të cilat shtylla janë rrezuar nga era dhe nuk e diji a i inspekton ndokush rrugët dhe a merr masa. Pyetja e dytë për drejtorin e kadastrit: Transiti ju ka marrë disa prona disa banorëve akoma pa u bërë dëgjimi publik. Për drejtorin e urbanizmit: Rruga në Gjurgjevik të Madh vende vende është e pakalueshme po ashtu edhe në Jashanicë. A keni projekt për rehabilitimin e tyre.

**z. Qendrim Millaku, drejtor I SHP:** Ne për meremetimin e rrugëve e kemi paraparë dhe aty ku kemi kërkesa nga banorët do ta rregullojmë.

**z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit:** Ne ju kemi thënë në mënyrë zyrtare operatorëve që në tokat private pa u krye konsultimi publik, pa u përfunduar procedurat mos të veprojnë por nëse ata bëjnë marrëveshje mes vete, unë nuk e diji. Deri tani ajo që është duke u punuar është në pronën publike. Për shtyllat në Shtupel, ne do të shohim se a ka afat kontrata. N♪7se ka afat, ne do ta obligojmë operatorin që ti rregulloj.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Lidhur me transitin, ne e kemi kompletuar dhe e kemi dërguar elaboratin e shpronësimit. Është kompetencë e nivelit qendror shpronësimi.

Seanca përfundoj me përfundimin e pikës së fundit të Rendit të Ditës. Duke falënderuar ët gjithë për pjesëmarrje dhe kontribut, kryesuesi I Kuvendit z. Fadil Gashi e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Procesmbajtës: Kryesuesi:

Skënder Behramaj Fadil Gashi

# RAPORT MONITORUES

## PËR ZBATIMIN E HARTES ZONALE KOMUNES SË KLINËS PËRIUDHEN

## 01.01.2024 deri 31.12.2024

Prill 2025

## Përmbajtja:

1. Hyrje …………...…………………………………………………….....…………………3

2. Permbledhje e e HZK-së. ………………………………………………………..……..……3

3. Permbledhje ekzekutive. …………………………………………………………….……4

4. Qellimi i raportit mbi vleresimin e zbatimit tė HZK... …………………………………………………4

S. Procesi dhe metodologjia e punës.. …………………………………………………….……5

6. Korniza e monitorimit të zbatimit tė HZK...……………………………………………………5

**II.MONITORIMI I ZBATIMIT TE HZK SIPAS FUSHAVE SEKTORIALE……………………..6**

7. Analiza dhe rezultatet e vlerësimit te zbatimit të HZK……………………………………..…..6

8. Zbatimi i HZK-së ne aspektin urban për periudhen 01 janar 2024 – 31 dhjetor 2024………………...6

9. Vlerësimi i pergjithshem i efekteve bazuar ne monitorimin e zbatimit t& HZK ne aspektin urban.…..7

10. Gjendja mjedisore…………………………………………………….………………………8

11. Shkalla e ngritjes së cilësise se sherbimeve publike dhe emergjente……………….……….………10

12. Shkalla e ngritjes së cilesisë se sherbimeve transportuese dhe teknike…………………….….….……16

13. Perqindja e realizimit te investimeve kapitale publike dhe publiko private të realizuara ne periudhën e caktuar në kuader te infrastrukturës dhe sherbimeve publike……………..……………….….……16

14. Shkalla e investimeve te mëdha te planifikuara…………………………..……………….……17

15. Trafiku rrugor dhe projektet e realizuara ne infrastrukture. ……………….………..….…………17

16. Projektet e realizuara në kuader të shëndetësise dhe mirëqenies sociale. ……………………..……24

17. Projektet e realizuara në kuadër të Arsimit. ……………………………….………………..…33

18. Projektet e realizuara në kuader te Zhvillimit Ekonomik.. ………………..……..………..…33

19. Shkalla e prodhimtarisë. …………………………………………..…………..………..35

20. Anketimet e familjeve bujqesore.. …………………………………….……..………………35

21. Vlerësimi i pergjithshëm per te arriturat sipas fushave sektoriale…………..…………..……….…..38

**III. PËRFUNDIMTARE**

22. Rishqyrtimi i permbajtjes dhe permasave të ndiyshim plotësimeve, perjashtimeve dhe bonuseve të zonimit………………………………………………….……………….…………….….……..38

23. Përfundim……………………………………………………………………..….……39

## 1. HYRJE

Në mbeshtetje te Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinoi, Autoriteti komunal per planifikim dhe menaxhim hapësinor, ne këte rast Drejtorati për Planifikim, Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit (DPUMM) ështe pergjegjës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunes.

Kuvendi i Komunës së Klinëst ka miratuar Hartën Zonale të Komunes (HZK) 2021 -2029 me

Vendimin 01 Nr. 60-10081/2020 të dates 21.05.2020

Haitimi i Raportit per monitorimin e zbatimit te dokumenteve lë planifikimit hapësinor vie si kërkesë e nenit 10 paragrafi 3 te Ligjit për Planifikimin Hapesinor, perkatesisht nenit 42 dhe 43 të Udhëzimit Administrativ Nr:24/2015 mbi Elementet dhe Kerkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

Ky Raport per monitorimin e zbatimit të HZK-se perfshinë periudhën një vjeçare nga data 01 Janar 2024 deri me 31 Dhjetor 2024.

Sipas nenit 42 dhe 43 të Udhezimit Administrativ Nr.24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore per Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, DPUMM ështe pergiegjës për monitorimin e zbatimit te HZK-se në koordinim dhe bashkëpunim me drejtorite pergjegjese sektoriale. Ndërlidhur me këte, përveç DPUMM edhe drejtorite tjera sektoriale kane pergatitur te dhenat për zbatimin e planeve zhvillimore sipas fushave të caktuara te cilat janë perfshirë ne këte Raport.

## 2. PËRMBLEDHJE E HZK-së

Harta Zonale e Komunës (HZK) është një dokument multi-sektorial që, përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit, përcakton hollësisht llojin, destinimin dhe shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës, si dhe masat e veprimit. Këto masa bazohen në projeksione të realizueshme të investimeve publike dhe private, duke mbuluar të gjithë territorin e Komunës për një periudhë minimale prej tetë (8) vjetësh.

Qëllimi kryesor i HZK-së është ruajtja e pasurisë dhe mirëqenies publike, duke kontrolluar vendndodhjen, vëllimin dhe shfrytëzimin e parcelave, objekteve dhe strukturave ndërtime. Kjo arrihet përmes zhvillimit të qëndrueshëm të tokës brenda territorit komunal. Po ashtu, HZK përcakton planifikimin hapësinor dhe kushtet për zhvillimin urban në kuadër të pronave private, duke ofruar informacione të qarta për qytetarët mbi mundësitë e shfrytëzimit dhe zhvillimit të pronave të tyre.

HZK konsiderohet si një mjet për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), duke shërbyer edhe si mekanizë për mbrojtjen e komunës nga ndikimet negative në mjedis dhe nga zhvillimet e paplanifikuara. Gjithashtu, HZK ka rol të rëndësishëm në promovimin e zhvillimit ekonomik dhe social në të gjithë territorin komunal. Kështu, ai funksionon si një instrument për orientimin dhe mbështetjen e zhvillimeve, duke promovuar qëndrueshmërinë socio-ekonomike.

HZK përmban një elaborim të hollësishëm mbi kufijtë e zonave dhe kushtet zhvillimore për secilën zonë brenda Komunës së Klinës. Definimi i zonave është bërë përmes hartës së shfrytëzimit të tokës, e cila përcakton njësitet hapësinore dhe destinacionin e tyre, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2013-2023.

Emërtimi i zonave është përputhur me Udhëzimin Administrativ për normat teknike të planifikimit hapësinor. Në caktimin e zonave, është aplikuar parimi i sigurimit të zhvillimit të planifikuar, duke u bazuar në gjendjen faktike. Harmonizimi i kërkesave të interesit publik me të drejtat mbi pronën private, promovimi i shëndetit dhe sigurisë publike, si dhe kapacitetet e planifikuara të shërbimeve dhe objekteve publike e private, janë marrë në konsideratë, sidomos në përcaktimin e zonave të banimit dhe shërbimeve.

Zonat me vlera natyrore, trashëgimi kulturore, zonat e interesit të veçantë si dhe sipërfaqet ujore janë përcaktuar bazuar në parimin e mbrojtjes së karakterit natyror, historik, kulturor dhe peizazhor. Për këto zona, janë zbatuar kritere të cilat burojnë nga vendimet dhe legjislacioni i fushave përkatëse.

## 3. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rezultatet e arritura gjate periudhes raportuese dhe ge kane implikime hapesinore sipas HZK mund te permolidhen ne faktet me te rendësishme si:

- Shqyrtimi i shumices se kerkesave te parashtruara ne fushen e ndertimit, perfshire ato per kushte dhe leje ndertimi. Ne kuader të kerkesave per kushte ndertimi, jane miratuar treth 59.39% prej lyre, kurse per leje ndërtimi jane miratuar rreth 76% te kerkesave te shqyrtuara.

- Kerkesat per certifikate perdorimi - nga 3 te parashtruara, prej tyre 2 jane miratuar dhe 1 refuzuar.

- Kerkesat per trajtimin e ndërtesave pa leje jane shqyrtuar ne nivelin e duhur dhe perfundimisht ky proces eshte duke u menaxhuar me sukses.

- Projektet ne infrastrukture publike jane realizuar dhe gjenden ne realizim e siper sipas Planit te Veprimit te percaktuar me HZK dhe me planifikimin buxhetor per vitin 2023 dhe 2024.

- Projektet jera sipas fushave sektoriale dhe te cilat nuk kane pasur implikime hapësinore jane realizuar ne nivelin e planifikimeve vjetore.

Pergjithesisht, nese i referohemi te dhënave statistikore, vleresohet se zbatimi i HZK-se eshte në nivel te arsyeshëm. Megjithate vlerësojm se gjendja reale mund te jetë pak më ndryshe për shkak se shumë palë te interesuara nuk kane aplikuar per ndërtim pasi qe paraprakisht janë njoftuar me kushtet e percaktuara me HZK dhe ne disa raste me pamundesinë e ndërtimeve në pronat e tyre.

DUMM për te giitha lejet ndërtimore të leshuara respekton destinimin e zonave, pastaj kujdeset qe të krijoj siguri per banorët, le siguroj cilësi te jetesës sipas normave urbane dhe aplikon të gjitha kerkesat per mbrojtje te mjedisit.

## 4. QËLLIMI I RAPORTIT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË HZK

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të ofrojë informacione themelore mbi shkallën e zbatimit të objektivave dhe synimeve të parashikuara në Instrumentin e Integruar të Zhvillimit Komunal (IIZK), si dhe të japë rekomandimet e nevojshme për zbatimin e HZK-së dhe vazhdimin e procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.

Monitorimi i zbatimit të HZK-së mundëson një analizë të detajuar mbi zhvillimin e komunës pas realizimit të aktiviteteve të planifikuara, duke reflektuar mbi gjendjen aktuale hapësinore dhe rezultatet e arritura. Një përqendrim i veçantë i jepet ndikimit hapësinor të projekteve të zbatuara, veçanërisht atyre në fushën e ndërtimit të objekteve banesore dhe afariste, si dhe atyre të realizuara brenda infrastrukturës publike.

Përveç këtyre aspekteve, raporti përmban gjithashtu teknikat, mjetet dhe metodologjinë e përdorur për vlerësimin e planit, të cilat janë zhvilluar me qëllim sigurimin e një qasjeje sa më objektive dhe efektive ndaj procesit të monitorimit.

## 5. PROCESI DHE METODOLOGJIA E PUNËS

Ky raport është hartuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit (DPUMM) në bashkëpunim me drejtoritë komunale përkatëse, të cilat mbulojnë fusha të ndryshme sektoriale. Për realizimin e procesit të monitorimit, DPUMM ka zhvilluar një sërë mjetesh dhe metodologjish pune, të cilat mund të përdoren dhe të avancohen më tej për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të zbatimit të planeve në të ardhmen.

Mjetet e zhvilluara gjatë këtij procesi janë konceptuar në përputhje me strukturën dhe llojin e HZK-së dhe përfshijnë:

- Kornizën për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit të drejtorive sektoriale, në përputhje me objektivat e HZK-së;
- Analizën e procesit të shqyrtimit të kushteve ndërtimore në bazë të kërkesave dhe sfidave të hasura gjatë trajtimit të tyre, duke u raportuar ndaj kushteve të përcaktuara në HZK;
- Vlerësimin e ndikimeve që kanë rezultuar nga zbatimi i projekteve të planifikuara;
- Zbatimin rigoroz të rregulloreve dhe lejeve mjedisore komunale;
- Krahasimin ndërmjet ndarjeve buxhetore dhe nivelit të realizimit të projekteve.

Metodat e zbatuara për përpilimin e këtij raporti monitorues janë të shumta dhe përfshijnë bashkëpunimin e ngushtë me drejtoritë komunale sektoriale, të cilat kanë siguruar të dhëna të rëndësishme mbi monitorimin e zbatimit të HZK-së përmes realizimit të projekteve dhe planeve zhvillimore.

## 6. KORNIZA E MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË HZK

Monitorimi i zbatimit të HZK-së bazohet në të arriturat zhvillimore të komunës. Procedura e monitorimit përfaqëson një mekanizëm për konfirmimin e përmbushjes së objektivave në raport me projektet e planifikuara dhe rezultatet e pritura. Megjithatë, ky proces nuk mund të japë një përgjigje të drejtpërdrejtë dhe përfundimtare brenda një periudhe të caktuar, pasi zbatimi i planeve është një proces kompleks që përfshin një sërë veprimesh të ndërlidhura, të cilat procedohen administrativisht dhe zhvillohen në një periudhë relativisht të gjatë kohore.

Për më tepër, periudha kohore për monitorimin e zbatimit të HZK-së, e cila përfshin intervalin nga 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2024, e bën këtë proces edhe më të ndërlikuar për shkak të:

- Planifikimit dhe miratimit të buxhetit për një vit fiskal;
- Realizimit të disa projekteve brenda një viti fiskal dhe të tjerave në një periudhë më të gjatë se një vit fiskal.

Vlerësimi i monitorimit të zbatimit të HZK-së përfshin aplikueshmërinë e normave dhe standardeve teknike urbane në trajtimin e kërkesave për ndërtim dhe shfrytëzimin e hapësirës në Zonën e Banimit dhe Zonën Mbishtresore. Në këtë kontekst, vlerësimi i monitorimit të HZK-së është realizuar duke marrë në konsideratë planet e veprimit të fushave sektoriale dhe nivelin e realizimit të tyre në përputhje me Planin e Veprimit, sipas Shtojcës 1 të përcaktuar në HZK.

## II. MONITORIMI I ZBATIMIT TE HZK SIPAS FUSHAVE SEKTORIALE

## 7. ANALIZA DHE REZULTATET E MONITORIMIT TE ZBATIMIT TE HZK

Në kuadër të zonave të përcaktuara në HZK janë përfshirë një sërë veprimesh për çdo fushë sektoriale. Këto veprime janë të përkufizuara në aspektin e kohëzgjatjes dhe periudhës së realizimit brenda viteve 2023 dhe 2024, si dhe implikimeve financiare, duke u ndërlidhur me planifikimin dhe buxhetimin afatmesëm për periudhën 2023-2026.

Është bërë identifikimi i veprimeve që janë realizuar, si dhe atyre kryesore (synimeve) që planifikohen të përfshihen në planet e ardhshme. Zbatimi i aktiviteteve dhe projekteve të propozuara ka shërbyer si bazë për vlerësimin e ndikimit në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social dhe hapësinor të komunës.

Monitorimi është realizuar për çdo fushë sektoriale dhe është mbështetur në vlerësimin e zyrtarëve përgjegjës të Komunës së Klinës lidhur me të arriturat në sektorët përkatës.

## 8. ZBATIMI I HZK-së NE ASPEKTIN URBAN PËR PERIUDHEN 01 JANAR 2023 – 31 DHJETOR 2024.

### 8.1. Kerkesat per kushte ndertimore:

Kerkesat per kushte ndrtimore paraqesin nje nga aktivitetet themelore që zhvillohen ne fushen me urbanizmit, njekohesisht edhe gëshjen me të nderlikuar për zbatimin e kritereve tẽ pärcaktuase meHZK në raport me kerkesat e palëve, e në raste të caktuara kjo çeshtje është teper sfiduese në procesin ankimor:

Per periudhen raportuese vereher nje mitje e numrit të kërkesave të parashurara per kushtendërtimore krahasuar me periudhen paraprake raportuese.

### 8.2. Kerkesat për leje ndertimore:

Në periudhen raportuese per leje ndertimi jane pranuar **73 kërkesa për leje ndërtimi**, prej të cilave 57 janë miratuar, 12 janë refuzuar dhe 4 lëndë janë ende në process, ku brenda asaj periudhe keerkesa te tjera janë në proces te shgyrtimit. Parashtrimi i kerkesave per leje ndërtimore varet dreitperdrejtë nga kerkesat e miratuara per kushte ndërtimore".

Statusi i kerkesave per leje ndertimi per vitin 2024.

729 lëndë të miratuara, prej të cilave janë:

| Kushte të ndërtimit | Leje ndërtimi | Leje mjedisore | Leje legalizimi | Leje rrënimi |
|---|---|---|---|---|
| 75 | 57 | 18 | 90 | 4 |

492 lëndë janë: referenca, vërtetime, pëlqime, procesverbale, vendime, fatura, njoftime, shkresa dhe kërkesa të ndryshme.

| Lëndë që janë në proces | Lëndë të refuzuara | Lëndë të pezulluara | Lëndë të hedhura poshtë | Lëndë të anuluara | Lëndë të pranuara | Lëndë të ceduara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 81 | 148 | 24 | 56 | 0 | 0 |

### 8.3. Certifikatë përdorimi:

Në periudhen raportuese jano pranuar 3 kerkesa për çertifikate përdorimi.Te glitha kerkesat kanë genë për kategorinë e Il-tė ndërtimeve.

Prej tyre janë miratuar 5 kerkesa, nje e refuzuar dhe një e pezulluar. Ne proces janë edhe dy

### 8.4. Legalizimet:

**90 kërkesa për legalizim të ndërtimit,** prej tyre 62 janë miratuar, 24 janë në listën e pritjes, 4 janë refuzuar dhe 2 janë në proces të vazhdimit të punimeve.

### 8.5. Informacione/ekstrakte nga HZK:

Per periudhen raportuese janë pranuar 9l kerkesa per informacione urbane. Për 83 kerkesa janë dhëne informacionet urbane/ ekstraktet nga HZK, 7 kerkesa jane refuzuar dhe një eshte ne proces.

### 8.6. Ceshtje të tjera:

Në kudër të çeshtjeve të tjera tematike nga fusha e planifikimit hapësinor dhe bazuar ne HZK eshtë bere hartimi i projekteve te detajuara per objekte te ndryshme infrastrukturore, duke perfshire:

- Projektet për hapjen dhe ndërtimin e rrugëve te reja;

- Projektet per ndërtimin e shkollave dhe gerdheve;

- Rregullimi dhe pastrami I shtretërve te lumenjëve/prrockave;

- Projekte të tjera te infrastrukturës publike dhe socialc.

## 9. VLERESIMI I PERGJITHSHEM I EFEKTEVE BAZUAR NË MONITORIMIN E ZBATIMIT TË HZK NE ASPEKTIN URBAN

Vlerësojme se ne periudhen raportuese, zbatimi i HZK ka shënuar nje nivel te arsyeshem ne fushen urbane, perkatesisht në fushen e ndërtimeve te ndërtesave me destinim si shtepi të veçanta banimi, të ndërtesave me shume mjësi banimi dhe afariste, si dhe te ndertesave te ndryshme afariste.

Nga monitorimi i zbatimit tė HZK ne aspektin urban, numri i kërkesave për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore të lëshuara për periudhën 3 Korrik 2024- Korrik 2024 na jep një pasqyre se në të gjitha këto kategori zbatueshmëria e HZK-së është ne nivelin mbi 50%.

Megjithate numri i kerkesave te miratuara dhe refuzuara per kushte ndërtimore, sigurisht do te kishte një pasqyrim më ndryshe po të mos ishin informacionet urbane qe iu ofrohen palëve sipas kerkesës se tyre para se te ushtrojne kerkese per kushte ndërtimore. konsultime te shumta me qytetare lidhur me mundesite zhvillimore ne pronat e tyre.

Eche metuje disa kritere urbane teknike tė HZK-se po konsiderohen si me stiduese dhe kane

ndikim te theksuar ne zhvillimin e planit hapesinor urban dhe realizimin e interesave te pronareve, perkatesisht ne denien e lejeve ndërtimore. Kjo situate pothuaj ne mase te njeje eshte ne te giitha

zonat urbane të Komunes, por në ato gendrore eshte me e theksuar. Kriteret e identifikuara ne HZK, ge konsiderohen si stide ne zbatim jane:

- Kriteri ge e definon largesine e vijes ndertimore nga truget ckzistuese dhe ato te planifikuara;

- Mosperputhjet ndermjet koeficientit te ndërtimit, etazhitetit dhe vleres se percaktuar per

shfrytezimin e siperfages ndertimore; dhe

- Kriteri per percaktimin e gjerësise se ballit (frontit) të paceles ndertimore pergiate trugeve ekzistuese dhe atyre te planifikuara si dhe ritja shtese ne raport me madhesine e siperfages mbi minimumin e percaktuar.

Po ashtu, per geshtjet urbane teknike nuk mund te kemi nje vlerësim te plote te zbatueshmerise se HZK pa nje vieresim specifik te nevojave dhe mundësive buxhetore per hapjen e trugeve te reja.

Hapja e trugëve te reja në zonat të cilat dominohen me pronesi private dhe ge kane ndodhur shit-blerje te shumta, eshte nje nga sfidat themelore nga e cila ceshtje po mjedhin reagime te ndiyshme lidhur me zbatueshmerine e HZK-se. Kjo problematike duhet te merret parasysh ne te ardhmen e aferme.

### 9.1. Synimi themelor per periudhen vijuese:

Perfundimi i hartimit te Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033.

Megjithate perfundimi I PZHK ka hasur ne veshtiresi dhe aktualisht eshte duke u vendosur ne shqyrtim publik, qe te vendoset Draft PZHK.

## 10. GENDJA MJEDISORE

Komuna e Klinës si edhe do komune tjeter perballet me disa meziqe mjedisore ne fusha te ndryshime.

Nder shkaktaret themelor te trezikimit te mjedisit konsiderohen: ujerat e zeza, degradimi i pyjeve dhe niveli i larte i dioksidit te karbonit si pasoje e veprimtarise se disa industrive te ndryshme, lirimi i gasrave nga garkullimi i automjeteve, veprimtarite e shume gurthyesve ge veprojne afer vendbanimeve dhe vlerave të mbrojtura natyrore, vendprodhimet e asfaltit, etj.

Lidhur me trajtimin e ujërave te zeza giate periudhes raportuese, Komuna e Klinës ka perfunduar disa projekte ne fushen e ndertimit te kanalizimeve. Po ashtu ne proces te zbatimit jane edhe disa projekte te ngiajshme brenda kesaj periudhe'. Por edhe metutje mbetet shqetesuese mungesa e impianteve per trajtimin e ujërave të zeza, te cilat projekte vleresojm se duhet zhvillar ne nivel kombetar.

Komuna e Klinës ka man masa te konsiderueshme edhe ne geshtjet preventive te vershimeve.Lidhur me kete jane regulluar shtreterit e disa lumenjeve dhe kanaleve kulluese.

Këto masa kane sjellur ne minimum meziget nga vershimet. Megjithate meziku me i mach nga vershimet ne Komuna e Klinës shkaktohen nga lumi "Drini Bardhë". Lidhur me këte, Komuna ka planifikuar vazhdimin e regullimit edhe te nje pjese te shtratit te lumit. Megjithate kjo geshtje shte nderkomunale dhe perfundimisht zgjidhja mund te arriet se bashku me komunat neper te cilat kalon ky lum apo sipas nje projekti te nivelit nacional.

Lidhur me degradimin e pyjeve pergiegjesia themelore tani eshte jashte autoriteteve komunale. Megjithate, Komuna shte duke e intensifikuar angazhimin ne fugizimin e kontrolleve ne kuader te pergiegjesive te saja.

Lirimin e gasrave nga industrite dhe bizneset e ndryshme, si dhe nga garkullimi i automjeteve - sidomos atyre te victra eshte eshtje ge duhet ta trajtojne organet e nivelit gendror.

Ne kuader te mbrojjes mjedisore, komuna ka mundäsuar kushtet per zhvillimin e disa projekteve te energise efiqiente ne kuader te disa ndertesave afariste dhe po ashtu ka realizuar disa projekte ne ndertesat shkollore.

### 10.1. Ndertimet dhe gjendja mjedisore

Ndertimet e ndërtesave te kategorise se Il-te jane te nderlidhura edhe me geshtjet specifike mjedisore, te cilat jane nen pergiegesine e autoriteteve kompetente te Komunes.

Per periudhen raportuese jane leshuar 18 Leje Mjedisore Komunale, kurse 1 jane refuzuar. Kurse nga MMPHI kemi pranuar 13 Leje Mjedisore.

Ne shqyrtimin e lëndëve per leje injedisore trajtohen elementet themelore te nikimeve ne mjedis, si në: efigencen e energie, caktohet lokacioni i kontenereve ne situacion, siperfaqia e gilbert, mbjellja dhe lokacionet e drunjeve etj.

Jane zhvilluar disa aktivitete vedijësusese mbi faktorët e ndotjes se mjedisit natyror. Gjate javes se Tokes, perkatesisht mbrojjes se mjedisit kei zhvillar aktivitete vedijesuse si imbjellja e luleve në gendren e gytetit tẻ Klines aktivitete me femijet e gerdhes se atetit, duke porfshire vizatime nga femijet për seshe mjedisore si shenje simbolike, pastaj pastrimi i disa sektorëve rrugor manja pjest ne konferenca aktivitete me organizata vendore dhe nderkombetare per lidhshmërine ekologiike në Kosove, mbjellja e drunjeve ne hapesira publike e shkolla me Eko Klubet e shkollave, shpindarja e broshurave per vedijesimin e gytetareve per mbrojjen e mjedisit, etj.




**Harta 40. Harta e Planit të menaxhmit të mbeturinave**

## 11. SHKALLA E NGRITJES SË CILESISE SE DREJTORISË PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENTE

Cilesia e sherbimeve publike ne Komunën e Klines ne vazhdimesi sa vie e tritet. Ne këte proces, faktor me ndikim themelor perveç investimeve te reja eshte mirembajja e infrastruktures se sherbimeve publike, ku përmes formes kontraktuale zbatohen aktivitetet e tilla, perve mirembajtjes se rrjetit të ujesjellesit dhe kanalizimit, si dhe menaxhimit te mbeturinave, per te cilat sherbime jane pergiegiese ndermarjet publike perkatese.

Kontratat per mirembajtie te infarstruktures prezantohen ne tabelen ne vijim:

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente, gjatë këtij viti është preokupuar në realizimin e plotë të punëve të planifikuara dhe mund të konstatojmë se ka qenë një vit shumë i suksesshëm. Gjatë periudhës vjetore 2024, në sektorin e shërbimeve publike, nga ana e palëve janë parashtruar gjithsej: 363 kërkesa, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me riparimin e rrugëve me zhavorr në fshatra dhe disa rrugica nëpër lagje të qytetit, riparimin e gropave në rrugët me asfalt, furnizimin me ujë dhe riparim të ujësjellësit, riparimin dhe kyçjen në kanalizim, leje për shfrytëzimin e hapësirës publike, kërkesat për ndriçimin publik dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, pastrimin e rrugëve nga bora, si dhe kërkesa për ndihmë me artikuj ushqimor dhe material ndërtimor për ndërtim apo renovim të shtëpive. Varësisht nga mundësitë buxhetore, jemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve. Nga ana e drejtorisë janë shqyrtuar këto kërkesa dhe gjendja është si në vijim:

| Përshkrimi | Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes 01.01.2024 – 01.01.2025 D.SH.P.E |
|---|---|
| Pranuar | 2 |
| Në Proces | 0 |
| Miratuar | 287 |
| Refuzuar | 57 |
| Hedhur Poshtë | 7 |
| Pezulluar | 5 |
| Ceduar | 0 |
| Anuluar | 5 |
| **GJITHSEJ** | **363** |

Ndërsa, sa ju përket projekteve të realizuara dhe në realizim e sipër për këtë vit, shkurtimisht po i theksojmë disa prej rezultateve të arritura për vitin 2024:

- **Trajtimi i qenve endacakë**

Qentë endacakë janë problem i gjithë Kosovës. Komuna e Klinës është ndër komunat e pakta të Kosovës që ka lidhur kontratë për trajtimin e qenve endacakë. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka lidhur kontratë me shumën 30,000 €, ku janë trajtuar, sterilizuar, shëruar, larguar dhe ushqyer qentë endacakë. Është bërë kastrimi i tyre dhe janë mbajtur, ushqyer dhe mbikëqyrur deri në shërimin e plotë të tyre. Pastaj, ata janë lëshuar përsëri në vendin ku janë kapur. Atyre ju ka kaluar tërbimi dhe rreziku nga ta, çka ka rezultuar në një sukses për ne, sepse janë eliminuar shumë rreziqe për qytetarët.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i kamerave të qytetit**

Është bërë zgjerimi i rrjetit të kamerave dhe vendosja e tyre në vende të reja. Tek salla “Adem Jashari” janë vendosur pesë kamera dhe është bërë mirëmbajtja e kamerave. Kontrata është lidhur më 18.04.2024 dhe është me vlerë 15,000 Euro.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i ndriçimit publik**

Gjatë këtij viti, në këtë kontratë kemi punuar në shumë fshatra për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, si p.sh., Zllakuqan, Volljakë, Rudicë, Ujmirë, Rixhevë, Gllarevë, Jagodë, Budisalc, Grabanicë, Gjurgjevik i Vogël, Deiq, Zajm dhe në Klinë dhe lagjet përreth qytetit. Kjo kontratë ka përfunduar në gusht të vitit 2024.

Kontrata e re për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në komunën e Klinës është lidhur më 27.09.2024 dhe është kontratë dyvjeçare.

- **Shtrimi i rrugëve fushore**

Gjatë vitit 2024, kemi vazhduar me shtrimin e rrugëve me zhavorr. Operatori ekonomik ka punuar në fshatin Gllarevë, në Jashanicë te lagjja e Hotëve dhe te varrezat, në Jashanicë te lagjja e Shpatve dhe varrezat e kuqve, në Jashanicë te lagja Haziraj dhe Isenaj, në Resnik tek rruga e Arave, dhe në Resnik te rruga e varrezave të fshatit dhe varrezat e martirëve, në Poterq, Gjurgjevik i Vogël, Rixhevë te varrezat e fshatit, Shtupel, Çabiq, Grabanicë,

Zllakuqan, Krushevë e Madhe në rrugë fushore dhe po ashtu te lagjja me komunitet, në Gremnik, Dollovë, Qeskovë dhe në fshatra të tjerë. Kjo kontratë ka përfunduar në fund të vitit 2024.

- **Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit**

Qyteti i Klinës ishte qyteti më i dekoruar në krahasim me qytetet tjera. Patëm numër të madh të qytetarëve që vinin edhe nga qytetet tjera, posaçërisht nga qytetet fqinje, për të kënaqur me atmosferën e krijuar për më shumë se një muaj rresht. Ka qenë kontratë trevjeçare dhe ka përfunduar me këtë vit.

- **Mirëmbajtja e stacionit të autobusëve në Klinë. Shërbime dhe siguri në stacionin e autobusëve të Klinës**

Komuna e Klinës ka lidhur kontratë ku kemi kërkuar që të ketë siguri dhe mirëmbajtje në stacionin e autobusëve. Kompania ka angazhuar punëtorë që kanë bërë mirëmbajtjen e objektit dhe stacionit në tërësi, duke u përkujdesur për rampën, personat dhe linjat e autobusëve sipas detyrave të përcaktuara në kontratë.

- **Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik**

Komuna ka investuar 206,550€ dhe ka lidhur kontratë më 08.05.2024, duke intervenuar në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik. Kemi zgjeruar ndriçimin në fshatra dhe pjesë ku nuk kishte ndriçim më herët, si p.sh., fshatrat Dush, Sferkë, Qupevë, Poterq, çabiq, Zabergjë, Përqevë, Radulloc, Zajm, Qeskovë, Bokshiq, Këpuz, Krushevë e Madhe dhe do të vazhdojmë në vitin 2025 në fshatrat Krushevë e Vogël, Drenoc, Leskoc etj.

Komuna ka lidhur kontratë me titullin: "Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbra (parqeve) në Zajm, Caravik, Poterq, Zllakuqan, Shtupel, Jashanicë, Gllarevë, Volljakë, Budisalc" lidhur nga komuna e Klinës më datën 12.06.2024, me nr. bazë 55-2024, me nr. protokolli 01/35218993/24, me nr. prokurimi 634-24-4343-5-2-1, me vlerë 36,150.00€ dhe me plan dinamik 30 ditë. Kontrata në fjalë është ekzekutuar në fshatin Caravik dhe përfshijnë hapësirën rekreative për fëmijë, restaurimin e kronit të vjetër të fshatit, shtigjet e ecjes, ulëset dhe ndriçimin e parkut dhe ndriçimin e rrugës kryesore nga parku deri te shkolla fillore, si dhe gjelbërimin e ulët dhe të lartë. Kontrata është përfunduar.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka ekzekutuar edhe një kontratë me titullin:

"Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbra (parqeve) në Zajm, Caravik, Poterq, Zllakuqan,

Shtupel, Jashanicë, Gllarevë, Volljakë, Budisalc" lidhur nga komuna e Klinës me datën

10.06.2024, me nr. bazë 54-2024, me nr. protokolli 01/352-18730/24, me nr. prokurimi 63424-4352-5-2-1, me vlerë 27,799.19 € dhe me plan dinamik 30 ditë. Kontrata në fjalë është ekzekutuar në fshatin Zajm dhe përfshijnë hapësirën e shtigjeve të ecjes, gjelbërimin e ulët dhe të lartë, ulëset dhe ndriçimin, gjithashtu rregullimin e kanalit për ujërat atmosferike. Kontrata është përfunduar.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka kontratë me titull “Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt në Jashanicë-Shtupel-Resnik-Klinë-Videjë ”, lidhur nga komuna e Klinës më datën 26.03.2024, me nr. bazë 22-2024, nr. protokolli 01/351/9907/24, me vlerë 224,475.00 €. Kemi punuar në fshatrat Shtupel, Jashanicë, Klinë, kryesisht me punimet e sanimeve të asfaltit, rikonstruimin e kabëzave, vendosjen e gypave dhe kapakëve të pusetave. Kontrata është në realizim.

Komuna e Klinës ka lidhur edhe kontratë me titulll: “Ndërtimi i rrethojave të varrezave në Zajm, Dobërdol, Sferkë, Gllarevë, Ujmirë” lidhur nga komuna e Klinës më datën 16.06.2024, me nr. bazë 57-2024, me nr. protokolli 01/351-18933/24, me nr. prokurimi 634-

24-4242-5-2-1, me vlerë 129,940.00€ dhe me plan dinamik 12 muaj. Deri tani është punuar në fshatrat Dobërdol dhe Ujmirë. Kontrata është në realizim.

- **Mirëmbajtja e drunjve dekorativë**

Në qytet kemi rreth 200 trupa të drunjve dekorativë, duke filluar nga sheshi “Ndue Perlleshi”,

“ Mujë Krasniqi” , “ Nënë Tereza” e deri te sheshi “Faruk Elezaj”. Duke qenë se për tre vite rresht kjo pjesë e qytetit ishte në ndërtim për shkak të punimeve të tunelit dhe kalldrëmit, drunjtë kishin pësuar dëmtime të mëdha. Prandaj, është dashur që në mënyrë profesionale të trajtohen të gjithë këta drunj, duke filluar nga krasitja, plehërimi, trajtimi me insekticide, instalimi i sistemit të ujitjes, punimi i tokës përreth, etj. Tani pemët kanë marrë formë të mirë dhe të njëtrajtshme, kanë rritje të mirë dhe janë të shëndetshme. Vlera e kontratës është 12,972.00€ dhe kontrata është trevjeçare.

- **Marrëveshje me Fondin për Energji Efiçiente (FKEE) për shtimin e masave efiçiente**

Drejtoria e Shërbimeve Publike ka aplikuar dhe ka arritur një marrëveshje të rëndësishme mes

Komunës së Klinës dhe Fondit për Energji Efiçiente, përmes së cilës është siguruar një investim prej 648,000 Euro. Ky investim ka si qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e disa banesave fituese në qytetin e Klinës, duke shtuar masat për energji efiçiente dhe Komuna ka për te bashkëfinancuar vetëm 10%.

Ky investim do të mundësojë një rritje të cilësisë së jetesës për qytetarët, duke u dhënë mundësinë të përfitojnë dhe të kursejnë shpenzimet mujore për energjinë elektrike dhe ngrohjen, ku do të ndërrohen dritaret, dyert, izolim me 12cm stiropor, kulmi me pjesët e tij përbërëse dhe do të montohet një inverter për ftohje-ngrohje të hapësirës, si dhe disa punë tjera përcjellëse. Për më tepër, ky projekt është në përputhje me angazhimet për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe uljen e emetimeve të gazrave serë, duke pasur një ndikim pozitiv në klimën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Klinës.

Drejtoria e Shërbimeve Publike është koordinatore dhe po vazhdon të punojë në mënyrë aktive për realizimin e këtij projekti dhe do të sigurojë mbështetje për qytetarët e përfshirë, duke i udhëzuar ata për të shfrytëzuar plotësisht mundësitë që ofron ky investim. Drejtoria e Shërbimeve Publike ka aplikuar edhe për ndërtesa tjera në Fondin për Energji Efiçiente dhe është në pritje të përgjigjeve për mbi 20 ndërtesa të tjera publiko-kolektive.

- **Furnizim me pajisje dhe mjete pune për zjarrfikësit**

Edhe këtë vit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka investuar në furnizimin e mjeteve për ndërhyrje të zjarrfikësve, duke u furnizuar me 1 hidrant, 2 fiskaja, 1 fshesë për mirëmbajtje dhe 1 vinç kran për tërheqje, të cilin e kanë montuar në kamion dhe maska kundër tymit.

- Furnizim me uniforma për zjarrfikësit

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka bërë edhe furnizimin e zjarrfikësve me uniforma, duke kuptuar angazhimin dhe punën e rrezikshme që bëjnë zjarrfikësit tanë. Ne kemi bërë një furnizim me uniforma duke i ndërruar uniformat e vjetra të tyre, të cilat në terren kanë pësuar dëmtime.

- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza Zllakuqan-JashanicëGllarevë

Ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza në fshatin Gllarevë, një projekt shumë i nevojshëm dhe i rëndësishëm, ka përfunduar.

Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Gllarevë ka qenë një nga premtimet e kryetarit Elezaj. Vlera e kontratës është 245,996.00€.

- Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe parqeve, trotuareve

Komuna e Klinës ka lidhur marrëveshje më datën 22.02.2024 për kryerjen e shërbimeve te kërkuara sipas kontratës, me pastrimin e shesheve dhe hapësirave gjelbëruese, me kompaninë KRM "AMBIENTI", njësia operative në Klinë. Kompania ka kryer me sukses shërbimet e kërkuara nga Komuna e Klinës, duke përfunduar obligimet e dhëna. Kontrata është trevjeçare.

- Njësia e Zjarrfikësve në Klinë

NJPZSH në Klinë, gjatë kësaj periudhe kohore, aktivitetin e vetë e ka bazuar në planin e punës për vitin 2024 dhe, si zakonisht, ka arritur t'i përmbush me sukses objektivat e parapara me plan.

NJPZSH ka vazhduar ta mbajë nivelin e gatishmërisë për reagime në rast nevoje edhe për raste emergjente për periudhën e lartcekur.

Ne jemi angazhuar që shërbimet tona të jenë në nivel të përgjegjësisë dhe detyrës që na obligojnë ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës.

NJPZSH është përgjigjur në thirrjet për raste emergjente sipas obligimeve dhe me kapacitetet tona ekzistuese, si dhe jemi përgjigjur me kohë qytetarëve të dëmtuar dhe kemi lëshuar vërtetime për zjarret (dëmet) e ndodhura.

Në NJPZSH në Klinë, disiplina në punë dhe respektimi i orarit të punës janë në nivel. Ndërrimet janë kryer sipas orarit të paraparë dhe niveli i gatishmërisë, si zakonisht, ishte në nivel të lartë për t'ju përgjigjur kërkesave-nevojave të qytetarëve të komunës sonë dhe më gjerë sipas nevojës dhe kapaciteteve tona ekzistuese.

Të dhënat e detajuara për intervenimet e NJPZSH gjatë periudhës janar-dhjetor janë paraqitur në tabelarin që pason:

| Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve të tjera janar-dhjetor 2024: | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2024 | Nr. i përgj. i daljeve | Nr. i zjarreve | Nr. Teknik | Nr. i shërbimeve | Aksidente rrugore | Vërshime | Të reshjeve | Të lënduar | | | Të vdekur | | | Gjithsej |
| Janar | 7 | 6 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 1 | 1 | 7 |
| Shkurt | 39 | 38 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 39 |
| Mars | 24 | 21 | 1 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 0 | 1 | 0 | 24 |
| Prill | 19 | 15 | 3 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 5 | 0 | 0 | 0 | 19 |
| Maj | 6 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 6 |
| Qershor | 7 | 5 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 |
| Korrik | 39 | 31 | 5 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 39 |
| Gusht | 69 | 61 | 5 | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 69 |
| Shtator | 29 | 24 | 2 | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 29 |
| Tetor | 12 | 9 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 12 |
| Nëntor | 7 | 5 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 |
| Dhjetor | | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Gjithsej | | | | | | | | | | | | | | **258** |

## 12. SHKALLA E NGRITJES TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE TRANSPORTUESE DHE TEKNIKE NË KOMUNËN E KLINËS

Fusha e shërbimeve të transportit në Komunën e Klinës është duke u përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe zhvillimin urban e rural. Komuna e Klinës ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ofrimin dhe subvencionimin e transportit publik rural, me qëllim të përmirësimit të qasjes në shërbime për të gjithë banorët, veçanërisht ata që jetojnë në zonat e largëta.

Transporti publik është i organizuar me autobusë, të cilët operohen nga kompani private, ndërsa shërbimi përfshin lidhjen ndërmjet vendbanimeve rurale dhe qytetit të Klinës. Sipas Planit të Transportit Publik, janë përfshirë linja të rregullta me orare të përcaktuara dhe vendndalje për marrje dhe zbritje të udhëtarëve, duke mbuluar pjesën më të madhe të territorit të komunës.

Në kuadër të këtij organizimi:

- Janë të planifikuara më shumë se 20 linja që lidhin vendbanimet kryesore me qytetin e Klinës;
- Të gjitha vendbanimet rurale janë të lidhura me rrugë të asfaltuara me qytetin, çka ka ndikuar pozitivisht në qasjen në transport;
- Është bërë mirëmbajtja e stacioneve ekzistuese të autobusëve dhe janë planifikuar ndërhyrje për ndërtimin e vendndaljeve të reja sipas nevojave.

Në territorin e Komunës së Klinës operojnë disa operatorë të transportit me autobusë dhe një numër i konsiderueshëm i operatorëve të transportit me taksi, të cilët mbulojnë zonat urbane dhe rurale.

Përveç kësaj, në përputhje me HZK-në, është punuar në përmirësimin e infrastrukturës së sinjalistikës rrugore (shenjëzimi horizontal dhe vertikal), sidomos në zonat afër shkollave, tregjeve dhe qendrave të banuara. Janë ndërtuar trotuare të reja dhe ndriçim publik në disa segmente të rrugëve lokale me qëllim rritjen e sigurisë në trafik.

Me rritjen e numrit të mjeteve të transportit publik dhe përmirësimin e infrastrukturës shoqëruese, është arritur një ngritje e ndjeshme e cilësisë së shërbimeve të transportit për qytetarët e Klinës, duke përmirësuar ndjeshëm efikasitetin, sigurinë dhe lehtësinë e lëvizjes në të gjithë territorin e komunës.

## 13. PERQINDJA E REALIZIMIT TE INVESTIMEVE KAPITALE PUBLIKE DHE PUBLIKO PRIVATE TE REALIZUARA NË PERIUDHEN E CAKTUAR NË KUADER TË INFRASTRUKTURES DHE SHERBIMEVE PUBLIKE

Perqindja e realizimit te investimeve kapitale publike te realizuara ne infrastrukture dhe shërbime publike per periudhen raportuese eshtë:

Për periudhen janar – shtator 2024 janë shpenzuar 92.33% të buxhetit të ndarë në kalegorinë ekonomike "investime kapitale" ose e shprehur në vlere monetare 4,605,207.02€

Për periudhen janar - qershor 2024 janë shpenzuar 46.37% të buxhetit te ndare në kategorine ekonomike "investime kapitale" të buxetit te planifikuar ose shprehur ne viere monetare 2,964,957.21€.

Për periudhen raportuese nuk ka pasur investime publiko private permes formave të caktuara të partneritetit.

Sfide themelore ne periudhen raportuese per realizimin e projekteve kapitale ishte inflacioni i vazhdueshem I cili nuk eshte subvencionuar nga orgenet e Nivelit Qendror. Sfide kryesore ishte procesi i shpronësimit( process tejet te zgjatur per mes procedurave te vlersimit dhe vendimeve) të disa pronave per realizimin e disa projekteve me interes të pergiithshem publik.

## 14. SHKALLA E INVESTIMEVE TË MEDHA TË PLANIFIKUARA

Ndarja buxhetore per vitin 2024 për Komunën e Klinës është 15,866,596.94 €, kurse vetëm per investime kapitale 4,987,996.79€.

Ne kuader te investimeve më të mëdha të planifikuara per vitin 2024 perfshihen:

## 15. TRAFIKU RRUGOR DHE PROJEKTET E REALIZUARA NE INFRASTRUKTURE PUBLIKE

Ne kuader të projekteve te realizuara në kuader të trafikut mugor dhe të infrastruktures publike për periudhen raportuese përfshihen:

| NR | Nr. i kontratës | Emërtimi i kontratës | Vlera e kontratës 2023-24-25 (€) | Rrugë të asfaltuara (m) | Kanalizim fekal (m) | Trotuar | Ndriçim elektrik (m) | Shtratii lumit (m) | Përfundimi i projektit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 84-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Zllakuqan-Pataqan - Berkovë | 119,804.00 | 500 | | | | | Vazhdon |
| 2 | 78-2024 | Rregullimi i trotuarit dhe shtegut për biçikleta me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë | 649,909.00 | | | 500 | | | Vazhdon |
| 3 | 91-2024 | Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104 lot1 | 1,709,978.00 | | | | | | Vazhdon |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 92-2024 | Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104 lot2 | 1,977,619.35 | | | | | | Vazhdon |
| 5 | 93-2024 | Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104 lot3 | 1,154,823,27 | | | | | | Vazhdon |
| 6 | 94-2024 | Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104 lot4 | 1,420,000.77 | | | | | | Vazhdon |
| 7 | 95-2024 | Ndërtimi i rrugës transit në Klinë nga N-9 deri në R-104 lot5 | 2,023,000.00 | | | | | | Vazhdon |
| 8 | 96-2023 | Ndërtimi i urës dhe rrugës në fshatin Budisalc-Rudic | 60,178.20 | | | | | | Përfunduar |
| 9 | 120-23 | Asfaltimi i rrugëve Gremnik, faza II | 44,900.00 | 1200.00 | | | | | Përfunduar |
| 10 | 97-2024 | Projekte zbatuese | 300,000.00 | | | | | | Vazhdon |
| 11 | 85-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore, Ranoc-Leskoc | 49,978.00 | | 1000.00 | | | | Vazhdon |
| 12 | 12-2024 | Ndërtimi i trotuarit me ndriçim në fshatin Poterq dhe Ndërtimi i rrugëve Poterq-Dugajevë Drenoc | 214,815.00 | | | | | | Vazhdon |
| 13 | 15-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Klinë-Shtupel-Kërrnicë | 299,000.00 | 1856.00 | | | | | Vazhdon |
| 14 | 17-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe | 169,999.82 | 1000.00 | | 730.00 | 730.00 | | Vazhdon |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbitokësore Grabanicë-Bokshiq-Dollovë | | | | | | | |
| 15 | 079-2023 | Asfaltimi i rrugëve Krushevë e Vogël | 64,485.00 | 969.00 | | | | | Përfunduar |
| 16 | 081-2023 | Asfaltimi i rrugëve lokale Ujmirë, Siqevë, Shtaricë, faza III | 34,688.50 | 150.00 | 1200.00 | | | | Përfunduar |
| 17 | 134-23 | Ndërtimi i liqenit akumulues për uji të pijes | 149,450.00 | | | | | | Përfunduar |
| 18 | 139-23 | Ndërtimi i ujësjellësit ne komunën e Klinës | 40,982.00 | | | | | | Përfunduar |
| 19 | 112-23 | Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Dresnik-Dollc, faza III | 198,500.00 | 1,150.00 | | | | | Përfunduar |
| 20 | 28-2024 | Ndërtimi i trotuarit Klinë-Zllakuqan (Krushevë e Vogël) | | | | 700.00 | 700.00 | | Përfunduar |
| 21 | 83-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë-Ujmirë-Shtaricë | 64,941.00 | 500 | 1200.00 | | | | Vazhdon |
| 22 | 042-2023 | Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Videjë Paskalicë-Krushevë e Madhe | 100,000.00 | | | | | | Përfunduar |
| 23 | 113-2023 | Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës | 43,999.95 | | 2410.00 | | | | Përfunduar |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nëntokësore Dresnik-Dollc, faza II | | | | | | | |
| 24 | 118-23 | Fasadimi i objekteve të vjetra, fasada V | 25,999.00 | | | | | | Përfunduar |
| 25 | 66-2024 | Ndërtimi i liqenit akumulues për uji të pijes, faza II | 29,948.00 | | | 105.00 | 505.00 | | Përfunduar |
| 26 | 14-2024 | Ndërtim i rrugëve dhe infrast. nëntokësore Videjë Paskalicë- Krushevë e Madhe | 119,000.00 | 1430.00 | | | 630.00 | | Përfunduar |
| 27 | 91-2023 | Ndërtim i trotuarit me ndriçim në fshatin Shtupel dhe Budisalc | 97,699.99 | | | | | | Përfunduar |
| 28 | 073-2023 | Asfaltimi i rrugëve lokale<br>Caravik çabiq, faza III | 61,000.00 | | | | | | Përfunduar |
| 29 | 083-2023 | Asfaltimi i rrugëve lokale Resnik- Jellovc Jashanicë | 229,999.00 | | | | | | Përfunduar |
| 30 | 076-2023 | Rregullimi i parqeve në Klinë | 20,000.00 | | | | | | Përfunduar |
| 31 | 40-2023 | PZHK | 27,376.00 | | | | | | Vazhdon |
| 32 | 103-2023 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore në Klinë ( SHESHI ) | 289,894.80 | | | | | | Përfunduar |
| 33 | 63-2022 | SHTEGU I BIÇIKLETAVE | 474,970.00 | | | | | | Përfunduar |
| 34 | 031-2023 | Asfaltimi i rrugëve lokale Zajm Deiq | 264,000.00 | | 453.00 | 1200.0 | 1200.0 | | Përfunduar |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 35 | 070-2023 | Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës Zllakuqan Pataqan Berkovë | 78,040.59 | 300.00 | | | | | Përfunduar |
| 36 | 072-2023 | Rregullimi i shtratit të lumit Klina | 746,046.00 | | | | 1065.00 | 500.00 | Përfunduar |
| 37 | 110-2023 | Ndërtimi i fundërruesit për sistemin e filtrimit të ujit të pijes në Klinë | 849,921.63 | | | | | | Vazhdon |
| 38 | 109-2023 | Hartimi i projekteve zbatuese | 50,000.00 | | | | | | Përfunduar |
| 39 | 89-2024 | Ndërtimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë-Volljakë | 8600 | | | | | | Përfunduar |
| 40 | 79-2024 | Punë shtesë Asfaltimi i rrugëve lokale Gremnik | 4125,00 | 160.00 | | | | | Përfunduar |
| 41 | 14-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Videjë-Polce-PaskalicëKrushevë e Madhe | 119,000.00 | 1430.00 | | | 630.00 | | Përfunduar |
| 42 | 13-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Sferkë-Volljakë-Qupevë | 249,500.00 | 3500,00 | | | | | Vazhdon |
| 43 | 20-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Madh | 99,944.50 | 1100.00 | | | | | Vazhdon |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 44 | 72-2024 | Ndërtimi i segmenteve të rrugëve Mal Bashota,Prekë Prendi,Dosidej Obradoviq,Bekim Fehmiu dhe infrastruktura nëntokësore Klinë-Dollc-Dresnik | 349,999.00 | 1000.00 | 1000.00 | | | | Vazhdon |
| 45 | 70-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore në fshatrat ZajmDeiq | 18,669.90 | | 1000.00 | | | | Përfunduar |
| 46 | 71-2024 | Rregullimi i shtratit të lumit Drenoc | 18,902.00 | | | | | 200 | Përfunduar |
| 47 | 52-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Jashanicë-Pogragjë-Resnik si dhe Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastruktura rrugore në Gryken e Jarinës-PogragjëJashanicë | 225,428.00 | 2000.00 | | | | | Vazhdon |
| 48 | 42-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Këpuz-Rastokë | 61,190.00 | 200.00 | 1000.00 | | | | Vazhdon |
| 49 | 41-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Vogël-Klinafc | 104,997.00 | 1000.00 | 1000.00 | | | | Vazhdon |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 50 | 36-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Budisalc-Rudicë dhe urës Rudicë | 39878.00 | 600.00 | 600.00 | | | 200 m pastrim | Përfunduar |
| 51 | 39-2024 | Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë | 82,000.00 | 1250.00 | 100.00 | | | | Vazhdon |
| 52 | 27-2024 | Ndërtimi i kanalizimit ShtupelBinxhë-Grabc | 79,999.00 | | 4000.00 | | | | Përfunduar |
| 53 | 110-2024 | Punë shtesë – Ndërtimi i kanalizimit Shtupel-KërrnicëBinxhë-Grabc | 7570.00 | | 385.00 | | | | Përfunduar |
| 54 | 108-2024 | Ndërtimi i shtratit Lumëbardhi i Pejës Drenoc-Grabanicë | 31,550.00 | | | | | 300.00 | Vazhdon |
| | | **TOTALI** | | **21295.0** | **15,348.0** | **3235.0** | **54600** | **1000.0** | |

Pra, gjatë periudhës 2024 janë punuar :

21, 295. 00 m (21.29 km) rrugë të asfaltuara

15, 348. 00 m kanalizim fekal

3, 235. 00 m trotuar

5, 460. 00 m ndriçim publik

1, 000. 00 m rregullim i shtratit të lumenjve

Rrugë të asfaltuara në komunën e Klinës në total janë: 480.76 km

Trotuare të ndërtuara në total janë: 33.48 km

Shtegu i biçikletave në total është: 4.9km

Gjatë kësaj periudhe, punëtorët e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit kanë marr pjesë në komisione për hapje dhe vlerësime të ofertave për projekte të ndryshme të Drejtorisë për Urbanizëm dhe drejtorive të tjera, si dhe komisione të ndryshme.

Janë mbajtur takime të ndryshme me donatorë si dhe dikasteret e linjës me qëllim të harmonizimit të punëve si dhe përfitimit të projekteve të ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe është bërë plani i punës dhe plani i prokurimit për vitin 2025, raporte mujore rreth punës së drejtorisë, janë bërë vlerësimet dhe sistemimet e dosjeve të këtij viti, si dhe punë tjera që kanë të bëjnë me planifikimin , detyrat dhe aktivitetet e drejtorisë.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka bërë edhe punë të tjera si: inspektime në terren sipas kërkesave të palëve, paramasa dhe parallogari për rrugë, rrënim të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, detyra projektuese, kërkesa, projekt-propozime, raporte, mbikëqyrje të projekteve, pranime teknike etj.

## 16.PROJEKTET E REALIZUARA NE KUADER TE SHENDETSISE DHE MIRQENIES SOCIALE

Ne kuader të projektet e realizuara ne kuader te shendetsise dhe mirqenies sociale për periudhen raportuese përfshihen:

Fushëveprimtaria:

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Shëndetësi, Statutin e Komunës së Klinës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet, drejtoria ka këtë fushëveprim:

- Vlerëson nevojat lokale shëndetësore;
- Harton buxhetin, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- Zbaton kujdesin parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare;
- Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore sipas akteve ligjore të miratuara nga MSh;
- Përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor;
- Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- Mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel të komunës;
- Mbledhë dhe analizon informatat në fushën shëndetësore në nivel lokal;
- Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve si dhe Qendrës për Punë Sociale;
- Organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën shëndetësore;

- Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale si dhe të arriturave komunale në këtë fushë;

- Harton propozimet për lirimet nga pagesa për shërbimet ndaj qytetarëve, nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin në fuqi;

- Ndërmerr veprime për të siguruar fonde të mjaftueshme për ngritjen e vazhdueshme profesionale të profesionistëve shëndetësorë nëpërmjet trajnimeve specifike, në harmoni me aktet ligjore në fuqi;

- Zbaton kujdesin parësor shëndetësor në sektorin publik, nëpërmjet shërbimeve të mjekësisë familjare, dhe përcjellja e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e komunës;

- Harton strategjitë për kujdesin parësor shëndetësor, bazuar në nevojat e identifikuara në nivel lokal duke u dhënë prioritet masave parandaluese, dhe në respektim të gjendjes shëndetësore, moshës, gjinisë dhe pozitës ekonomiko - sociale të qytetarëve dhe kushteve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit shëndetësor; kushteve teknologjike - mjekësore, distancës dhe konfiguracionit gjeografik, si dhe strukturës dhe përbërjes së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor;

- Ndërmerr masa parandaluese për zbulimin dhe diagnostikimin e hershëm, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;

- Organizon dhe zbaton procesin e imunizimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si një nga masat themelore të kujdesit ndaj shëndetit publik;

- Kujdeset për përparimin e shëndetit të fëmijëve, të rinjve dhe grupeve tjera;

- Promovon shëndetin oral dhe kujdesin themelor stomatologjik si dhe shëndetin mendor, në pajtim me metodat e avancuara;

- Kujdeset për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik të qytetarëve të komunës, nëpërmjet aktiviteteve parandaluese (por duke mos u kufizuar vetëm në këto), si: promovimi i mënyrës së shëndoshë të jetesës, edukimit shëndetësor, ndërmarrjes së masave të përgjithshme kundër epidemive dhe preventive, si: dezinsektimi hapësinor, deratizimi dhe dezinfektimi, kontrollimi i mjedisit, kontrollimi i shkaktarëve, si dhe parandalimi i sëmundjeve, çrregullimeve, lëndimeve dhe gjendjeve me rëndësi sociale mjekësore;

- Zhvillon programe për aftësimin profesional të punëtorëve shëndetësorë nëpërmjet "Zhvillimit të vazhdueshëm profesional" (ZHVP), me qëllim të ngritjes së cilësisë së kujdesit shëndetësor;

- Bashkëpunon me kujdesin dytësor dhe tretësor shëndetësor, në pajtim me legjislacionin në fuqi;

- Vlerëson nevojat lokale për shërbime sociale;

- Harton buxhetin, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;

- Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore sipas akteve ligjore të miratuara nga niveli qendror;

- Vendos dhe mbledh bashkëpagesat brenda kornizës së përcaktuar nga ministritë e linjës;

- Përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e shërbimeve sociale;

- Ofron shërbime sociale dhe përkujdesje për rastet sociale të popullatës, brenda territorit të komunës;
- Kujdeset për të drejtën për të pasur, zhvilluar dhe përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda territorit të komunës;
- Bashkëpunon me ministritë përkatëse për vendosjen dhe zbatimin e politikave sociale, për kategoritë e fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha grupet tjera në nivelin lokal, përmes QPS – së;
- Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- Mbledhë dhe analizon informatat në fushën sociale në nivel lokal;
- Organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën sociale;
- Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- Përgatit planet vjetore për zhvillimin dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbajtjen e shënimeve statistikore;
- Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministritë e linjës.

## QKMF / QMF / AMF – Raport i punës

Objektivi kryesor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, përgjatë vitit 2024, ka qenë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Gjatë këtaj periudhe kohore është bërë rritja e numrit të shërbimeve mjekësore të ofruara në QKMF, është përmirësuar furnizimi me medikamente për pacientët, janë përmirësuar shërbimet e patronazhit, kujdesit paliativ, etj.

Furnizimet mjekësore (barna dhe pajisje mjekësore) janë bërë me kohë dhe në sasi të mjaftueshme falë investimeve nga Komuna e Klinës si dhe nga Lista Esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë. Qytetarët tanë kanë marrë shërbime cilësore në QKMF dhe janë furnizuar në masë të madhe me barna.

Rritja e gamës së shërbimeve dhe cilësisë në Diagnostikë - Edhe në shërbimin e diagnostikës në QKMF janë kryer numër i madh i shërbimeve cilësore, analiza laboratorike dhe shërbime të röntgenit, me aparatura moderne dhe pa kosto për shumicën e qytetarëve. Më shumë se 22,000 qytetarë kanë kryer shërbime diagnostike, analiza laboratorike dhe shërbime të röntgenit. Gjatë vitit 2024 është bërë furnizimi me pajisje të reja mjekësore në sektorin e diagnostikës me theks të veçantë aparati i Mamografisë, vënia në funksion të të cilit ka ndikuar që shumë gra të kryejnë këtë shërbim pa pagesë në Klinë të cilat do të përmirësojnë edhe më shumë cilësinë e shërbimeve të ofruara si dhe do të rrisin edhe gamën e shërbimeve në diagnostikën

e QKMFsë. Vlera e pajisjeve të reja të blera në QKMF nga buxheti i komunës është rreth 85,000 euro. Gjithashtu, kemi pranuar donacione në pajisje të reja nga KFOR-i si dhe Ministria e Shëndetësisë.

Gjatë vitit 2024 nuk kanë munguar edhe investimet kapitale në QKMF, duke përmirësuar dukshëm kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve profesionale për qytetarët e komunës sonë. Janë krijuar hapësira të reja dhe është bërë renovimi i hapësirave ekzistuese për përmirësimin e shërbimeve mjekësore, ordinancave specialistike dhe barnatores së QKMF-së. Vlera e investimeve kapitale gjatë vitit 2024 ka qenë rreth 200,000 euro, prej tyre nga buxheti i komunës janë shpenzuar rreth 45,000 euro, rreth 140,000 janë shpenzuar nga zyra e BE-së në kuadër të projektit ”EU for All”, projekt ky që ka për qëllim përmirësimin e kushteve për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në objektin e QKMF në Klinë.

Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore për përmirësimin e shërbimeve mjekësore ka qenë prioritet edhe përgjatë vitit 2024. Është bërë trajnimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore përmes bashkëpunimit me organizata dhe institucione tjera relevante si dhe janë kryer procedurat e rekrutimeve për stafin mjekësor dhe teknikëve të infermierisë.

Ka vazhduar bashkëpunimi me donatorët ekzistues dhe janë zhvilluar takimet e reja me donatorët potencialë, ku janë prezantuar objektivat tona parësore dhe projektet e planifikuara.

**Vizitat Mjekësore**

| | Janar | Shkurt | Mars | Pril l | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Mjekësia Familjare | 7136 | 5788 | 3331 | 2959 | 5173 | 4116 | 4821 | 6107 | 4743 | 3886 | 3881 | 3984 | 55925 |
| Pediatria | 878 | 631 | 817 | 518 | 704 | 672 | 523 | 612 | 629 | 673 | 524 | 843 | 8024 |
| Gjinekologjia | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Stomatologjia | 153 | 165 | 68 | 153 | 155 | 102 | 193 | 181 | 150 | 0 | 166 | 143 | 1629 |
| Specialist ika | 1866 | 1921 | 1495 | 2148 | 1987 | 1465 | 929 | 2118 | 1844 | 2029 | 1746 | 1447 | 21095 |
| Totali | 10033 | 8505 | 5711 | 5778 | 8019 | 6355 | 6466 | 9118 | 7366 | 6588 | 6317 | 6417 | 96673 |

Vëmendje e madhe i është kushtuar programit për kujdesin mjekësor për të moshuarit, kujdesit paliativ dhe pacientëve terminal si dhe kujdesit mjekësor për komunitetet pakicë.

Është rritur angazhimi në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët 0-3 vjeç si dhe gratë shtatzëna dhe lehonat, duke pasur mbështetje të vazhdueshme edhe nga programi i UNICEFit. Është bërë ofrimi i shërbimeve mjekësore në shtëpi për pacientët që nuk kanë mundur të kryejnë shërbimet mjekësore në QKMF dhe AMF.

**Shërbimet Shëndetësore**

| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Barnatorja | 670 | 321 | 680 | 533 | 808 | 586 | 583 | 784 | 710 | 783 | 665 | 625 | 7748 |
| Echo | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 60 | 15 | 11 | 0 | 89 |
| Ekg | 142 | 95 | 162 | 87 | 42 | 139 | 35 | 120 | 198 | 153 | 86 | 119 | 1378 |
| Injeksione | 4059 | 2305 | 2684 | 2287 | 2447 | 2205 | 2781 | 3947 | 3259 | 3257 | 2746 | 3154 | 35131 |
| Infuzione | 2424 | 1536 | 1891 | 1326 | 1603 | 1841 | 2201 | 3025 | 2064 | 1838 | 1394 | 1600 | 22743 |
| Inhalime | 106 | 207 | 207 | 112 | 123 | 88 | 113 | 137 | 205 | 223 | 167 | 208 | 1896 |
| Laboratori | 1397 | 1282 | 1388 | 1374 | 1426 | 1135 | 1402 | 1184 | 1380 | 1411 | 1260 | 1526 | 16165 |
| Lidhje | 625 | 626 | 743 | 612 | 674 | 677 | 803 | 931 | 793 | 920 | 847 | 856 | 9107 |
| Qepje | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Rëntgeni | 518 | 508 | 606 | 520 | 535 | 419 | 543 | 401 | 467 | 651 | 394 | 234 | 5796 |
| Vaksinimi | 170 | 159 | 169 | 207 | 265 | 298 | 250 | 227 | 270 | 1282 | 546 | 197 | 4040 |
| Terreni | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 10111 | 7039 | 8530 | 7061 | 7923 | 7388 | 8711 | 10756 | 9406 | 10550 | 8129 | 8532 | 104136 |

**Sektori i Shërbimeve Sociale**

Gjatë vitit 2024, Sektori i Shërbimeve Sociale ka kryer shërbime të ndryshme në përkrahje të familjeve dhe personave në nevojë sociale. Në këto shërbime përfshihen nga këshillimi deri te përkrahja për familjet me probleme sociale, kujdesi dhe mbrojtja e fëmijëve, kujdesi dhe mbrojtja e të moshuarve, si dhe shërbime tjera shtesë administrative (vërtetime, deklarata të ndryshme dhe shkresa tjera).

Bashkëpunimi i Sektorit të Shërbimeve Sociale me Institucione të tilla si Policia e Kosovës, Prokuroria e Kosovës, Gjykata Themelore në Pejë - Dega Klinë, institucionet shkollore, zyra për ndihmë juridike falas, dhe OJQ të ndryshme ka qenë në nivelin më të mirë të mundshëm. Gjatë vitit 2024, Shërbimi Social ka realizuar vizita në familje të cilat kanë fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë në strehim familjar, fëmijë nën

kujdestari. Gjithashtu, ka marr pjesë në intervistimin e të miturve në polici, në seanca gjyqësore, si dhe ka realizuar vizita tjera në familje të ndryshme ku është paraqitur nevoja e ofrimit të shërbimeve sociale.

Më poshtë e keni raportin e sektorit të Shërbimeve Sociale në formë tabelore

| Nr. | Shërbimet e kryera | Numri i rasteve të reja | Numri i rasteve aktive (ekzistuese) | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kujdestari për fëmijë | 2 | 21 | |
| | Kujdestari për raste të veçanta | 2 | 2 | |
| 2 | Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin | 15 | 0 | |
| 3 | Adoptime – Periudhë provuese për Adoptim | 0 | 0 | |
| 4 | Dhunë në familje | 25 | 23 | |
| 5 | Strehim familjar brenda familjes biologjike/nr fëmijëve | 1 | 9 | |
| 6 | Strehim në shtëpinë e sigurt në Pejë | 7 | 0 | |
| 7 | Vendosje të fëmijëve në SOS fshatin e fëmijëve në Prishtinë | 0 | 1 | |
| 8 | Strehim i personave madhorë në Institutin e Special në Shtime dhe Deçan | 0 | 6 | |
| 9 | Strehim i fëmijëve në shoqatën "Caritas Umbria", në Leskoc | 0 | 3 | |
| 10 | Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin | 31 | | |
| 11 | Çrregullime familjare | 4 | 2 | |
| 12 | Përcjellje të kontaktit fëmijë-prind | 8 | 8 | |
| 13 | Shkurorëzime | 25 | 0 | |
| 14 | Fëmijë nga prindërit e shkurorëzuar | 41 | | |
| 15 | Strehim i të moshuarve në shtëpinë për të moshuar në Gurrakoc dhe Skenderaj | 0 | 5 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 16 | Vërtetime dhe deklarata | 496 | | |
| 17 | Kërkesa për mbështetje financiare familjes për fëmijë me nevoja të veçanta | 14 | 85 | |
| 18 | Pjesëmarrje në seanca gjyqësore dhe polici | 116 | | |
| 19 | Kujdestari për përfaqësime në seanca gjyqësore | 3 | | |
| 20 | Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për privim të së drejtës prindërore | 0 | | |
| 21 | Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për privim të zotësisë së veprimit | 3 | | |
| 22 | Propozime për Gjykatën Themelore në Klinë, për shërim të detyrueshëm | 1 | | |
| 23 | Kërkesa të ndryshme, Gjykatë, Polici, QKMF, Shëndeti Mendor në Pejë, konstatime zyrtare, pëlqime etj | 33 | | |
| 24 | Regjistrime të fëmijëve në Zyrën e Gjendjes Civile | 2 | | |
| 25 | Lindje jashtëmartesore | 1 | | |
| 26 | Anamneza sociale | 3 | | |

Sektori i Asistencës Sociale

Në periudhën që po raportojmë, numri i familjeve përfituese të Ndihmës Sociale në të dy kategoritë është 711.

Gjithashtu, gjatë periudhës që po raportojmë në bashkëpunim me Kuvendin Komunal, organizata humanitare, biznese të ndryshme dhe organizata joqeveritare, kemi ndihmuar disa familje nevojtare me pako të ndryshme (higjienike, ushqimore, veshmbathje).

Më poshtë e keni raportin e sektorit të Asistencës Sociale në mënyrë tabelore për periudhën raportuese:

| Aktivitetet | Kategoria I dhe II |
|---|---|
| **Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë** | 59 |
| **Sa prej tyre janë të aprovuara** | 40 |
| **Sa prej tyre janë të refuzuara** | 7 |
| **Sa janë në shqyrtim** | 12 |
| **Numri i rasteve të ndërprera** | 29 |
| **Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit e As. sociale** | 3 |
| **Numri i ankesave të aprovuara** | 0 |
| **Numri i ankesave të refuzuara** | 2 |
| **Nr. ankesave në shqyrtim** | 1 |

Realizimi i të hyrave nga Tarifat Administrative në Qendrën për Punë

Sociale

Bazuar në Rregulloren mbi Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, në Institucionin e QPSsë tarifohen disa nga vërtetimet që i lëshon ky institucion. Gjatë kësaj periudhe që po raportojmë, kemi arritur që të grumbullojmë një shumë të konsiderueshme të të hollave, të cilat janë derdhur në xhirollogarinë e Komunës së Klinës. Në vazhdim, në mënyrë të detajuar i keni të hyrat që janë grumbulluar për periudhën janar – dhjetor 2024:

| Muaji | Përshkrimi | Nr. & tarifa adm. | Shuma totale - Euro |
|---|---|---|---|
| Janar - Dhjetor 2024 | Vërtetim që nuk i është marr ose kufizuar aftësia për të vepruar (për marrjen e lejes për armëmbajtje) | 273 x 20 € | 5,460.00 € |
| Janar - Dhjetor 2024 | Vërtetim për lirim / fitim nga shtetësia e Kosovës | 170 x 10 € | 1,700.00 € |
| Janar - Dhjetor 2024 | Vërtetim që nuk është shfrytëzues i Asistencës Sociale | 47x 2 € | 94.00 € |
| Janar - Dhjetor 2024 | Anamnezë sociale | 4 x 5 € | 20.00 € |
| | | | **Totali: 7,274.00€** |

Sfidat

- Grumbullimi e të hyrave vetanake të mbledhura nga QPS në një kod të veçantë buxhetor të Qendrës për Punë Sociale/Shërbime Sociale, mjete që do të mund të shfrytëzoheshin për pagesat e punëtorëve që angazhohen jashtë orarit të punës/kujdestari, si dhe për nevoja tjera për ndihmë të menjëhershme familjeve në nevojë sociale.
- Rritja e buxhetit të Qendrës për Punë Sociale, tek kategoria e shpenzimeve -mallra dhe shërbime.
- Sigurimi i një veture për nevojat e Institucionit, pasi që me një veturë të vetme nuk po arrijmë t'i kryejmë të gjitha shërbimet në terren.

Përfundimi

Qendra për Punë Sociale, kujdeset për banorët e Komunës sonë në nevojë për shërbime sociale dhe ndihmë financiare, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni dhe orientime tjera. Shuma e të hollave që shpërndahen përmes këtij Institucioni brenda një viti kalendarik është rreth 1.1 milion euro, duke përfshirë këtu familjet përfituese të Asistencës Sociale, familjet që kanë fëmijë me nevoja të veçanta si dhe familjet që kanë në strehim fëmijë pa përkujdesje familjare. Konsiderojmë se, edhe përkundër disa sfidave, periudhën që po raportojmë e kemi përmbyllur me sukses, krejt kjo falë punës së stafit të QPS-së, me punën dhe angazhimin e të cilëve është bërë realizimi i planit dhe detyrave të punës. Gjithashtu, falë edhe bashkëpunimit të mirë më DSHMS-në, DPSF-në, si dhe me Institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare.

Mbesim me shpresë që angazhimi dhe bashkëpunimi në vitin e ardhshëm do të rritet, në mënyrë që të arrihet në plotësi realizimi i të gjitha detyrave dhe objektivave për vitin 2025.

16.1. Synimet themelore për periudhen vijuese:

Synim kryesor strategjik i DSHPS-se eshtë ruaitja e shëndetit të popullates, permes promovimit të mȇnyrave të shëndetshme të jetesës, ofrimit të sherbimeve shëndetësore te sigurta dhe cilesore, me gasje te lehtë dhe të barabart per te giithë gytetarët e Komunës se Klinës.

## 17. PROJEKTET E REALIZUARA NE KUADER TË ARSIMIT

Në fushën e arsimit ne vazhdimësi janë realizuar projekte te rendësishme dhe sipas planifikimit me HZK, duke perfshirë: ndërtimin e objekteve të arsimit parafillor, fillor dhe tể mesëm si dhe te infrastruktures perejellese. Po ashtu janë realizuar projekte per ritjen e cilesisë ne arsim, duke perfshire furnizimin e kabineteve dhe të sigurisë ne shkolla.

- **Furnizimi me Pompë Termike në SHFMU "Motrat Qiriazi" dhe "IAAP Fehmi Agani" Klinë.**
- **SHFMU "Motrat Qiriazi" Klinë** ka përfituar pompë termike në vlerë prej **60,150 euro**,
- **IAAP "Fehmi Agani" Klinë** është pajisur gjithashtu me pompë termike në vlerë prej **84,593 euro** ku 45,320.00 Euro janë paguar nga buxheti i vitit 2024 ndersa pjesa tjetër është realizuar në vitin 2023.
- **Renovimi i Gjimnazit "Luigj Gurakuqi" Klinë** .
- **Renovimi i Gjimnazit "Luigj Gurakuqi"** në Klinë, me një vlerë prej **56,689.40 euro**.
- **Ndërtimi i Fushës Sportive në SHFMU "Motrat Qiriazi" Klinë**.

Në kuadër të investimeve për përmirësimin e kushteve për aktivitete fizike dhe shëndetësore,është ndërtuar një fushë sportive në SHFMU "Motrat Qiriazi" në Klinë. Ky investim ka pasur një vlerë prej 20,000 euro dhe ka për qëllim krijimin e mundësive për zhvillimin e aktiviteteve sportive për nxënësit, duke kontribuar në përmirësimin e shëndetit dhe disiplinës fizike të tyre.

Ndërtimi i objekteve té reja shkollore, gerdheve per femije, sallave sportive, parqeve dhe këndeve te lojrave eshtë duke u zhvilluar né kuadër té kufinjëve tê percaktuar me hartën per shfrytezimin e tokës, prandaj ndërtimi i tyre eshte zhvilluar ne kuader te kufinjeve te percaktuar dhe nuk kanë implikime te veçanta hapësinore.

17.1 Synimet themelore per periudhen vijuese:

Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal per Arsimin Parauniversitar.

## 18. PROJERTET E REALIZUARA NE KUADER TE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Gjatë vitit 2024 janë kryer punët në harmoni me Statutin Komunal, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, Ligjin mbi Financat e Pushtetit Lokal, udhëzimet administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe bazauar në kompetencat dhe përgjegjësitë që dalin nga to. Të gjitha këto janë realizuar sipas Planit të Punës, të aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2024, siç vijon:

**Sektori për Financa**

- Gjatë vitit 2024, në zyrën e Bizneseve janë regjistruar 141 biznese të reja, përfshirë 42 biznese individuale, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar 99, si dhe biznese të shuara 35.
- Gjithashtu janë lëshuar edhe 62 licenca për taksi,18 aktvendimeve të linjave për itinerar të autobusëve, dhe 6 aktvendime të zgjatjes së orarit për biznese.
- Janë lëshuar më se 75 akte administrativo-juridike që ndërlidhen me Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.
- Janë lëshuar 18 certifikata të gjendjes ekonomike.
- Janë certifikuar të gjitha pagesat për mallra e shërbime dhe për punë.
- Janë lëshuar 16 aktvendime për shfrytëzimin e hapësirës komunale.
- Janë lëshuar 13 vërtetime për pension.
- Janë lëshuar 28 vendime pas shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave .
- Janë bërë të gjitha zotimet për shpenzimet e bëra gjatë vitit.
- Janë realizuar pagesa për taksa komunale për vetura dhe për automjete të rënda.
- Është bërë regjistrimi i rregullt i të hyrave vetanake të paguara përmes arkës dhe bankës.
  - Është bërë regjistrimi i pasurisë komunale në Freebalance.
- Është bërë barazimi i rregullt i të hyrave me Departamentin e Thesarit në baza mujore.
  - Janë bërë kërkesa për alokim të të hyrave sipas realizimit dhe buxhetit të planifikuar;

Ne kuader te zhvillimit ekonomik janë realizuar nje mori projektesh nga fusha tẻ ndryshme te ekonomise. Projekte te caktuara jane realizuar ne krijimin e kushteve infrastrukturore per zhvillim ekonomik, duke perfshire rehabilitimin e shtreterve te lumenjeve, ndertimin e rrugeve te kategorise se IV me gellim te permiresimit te kushteve ne sektorin e bujgesise, pastaj në ingritjen e kapaciteteve profesionale nierezore ne dege lë ndryshme te bujgësise, si dhe ne zhvillimin e kapaciteteve te jera teknike. Po ashtu jane realizuar projekte te ndyshme per perkrahjen materiale promovimit te tyre. te kategorive te ndryshme. Gjatë kësaj periudhe të vitit fiskal janar- dhjetor 2024, nga ZTP janë inkasuar gjithsej 550,

999.44 €, që është 59,537.16 € më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Nëse krahasojmë tatimin e faturuar dhe tatimin e inkasuar për vitin 2024, del se kemi inkasuar afërsisht rreth 52.32 % të tatimit të faturuar. Gjatë vitit 2024 kjo zyrë ka kryer edhe shumë punë të tjera, si: lëshimi i certifikatave dhe lëshimi i faturave apo kartelave financiare për qytetarë, pra për persona fizikë dhe juridikë.

Po ashtu, në vitin 2024 është bërë verifikimi i pronave në terren nga anketuesit. Janë verifikuar kryesisht zona e parë, e dytë dhe e tretë.

Prej tyre, regjistrime të reja (objekte të reja) të cilat tatimohen për herë të parë janë 308, të verifikuara me ndryshime 628, modifikimi i të dhënave të tatimpaguesit 1904.

**Raport financiar për buxhetin, të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2024**

Për të analizuar realizimin e buxhetit për vitin fiskal 2024, do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore, si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetorë të vitit paraprak. Shtojca e Raportit Financiar të vitit 2024 i bashkëngjitet këtij raporti.

Në Zyrën e Thesarit është tejkaluar planifikimi i realizimit të pagesave të certifikuara gjatë vitit 2024 sipas Buxhetit të aprovuar në vlerë prej:14,548,717€.

**19. SHKALLA E PRODHIMTARISË"** është tashmë përkthyer dhe adaptuar në mënyrë të saktë për Komunën e Klinës, bazuar në të dhënat përkatëse që më ke dhënë. Ajo përfshin:

- Numrin e përgjithshëm të bizneseve të regjistruara në Klinë (4,832), prej të cilave 2,143 aktive, 2,054 pasive dhe 635 të regjistruara rishtazi;
- Strukturën organizative (biznese individuale dhe SH.P.K.);
- Fushat më të zakonshme të aktivitetit (tregti, ndërtim, transport, shërbime);
- Shënimin se veprimtaritë prodhuese janë më të pakta;
- Mungesën e të dhënave të detajuara për nivelin e prodhimtarisë, por me theks në potencialin e tyre për zhvillim ekonomik.

## 20. ANKETIMET E FAMILJEVE BUJQESORE

Komuna e Klineskarakterizohet si vend i zhvilluar bujqesor dhe me potenciale te metejme tezhvillimit ne fushat e ndryshme te bujgesise.

Drejtorati i Bujgesise nuk ka bere anketim te ekonomive bujqesore ne terren, mirëpo posedon nje program te Ministrise se Bujgesise, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ne te cilin jane te registruar te 14 Ne kuader te zhvillimit ekonomik pertshihet edhe bujgesia me turizimin.gjithë fermerët e Komunës së Klinës, ku secili nê menyrê individuale ka deklaruar te dhenat per ekonomité bujgesore.

Komuna e Klinës ka nje sipërfage bujgesore prej 25,867 ha, ku sipas Agjencionit te Statistikave te Kosovës ne Komunên e Klinës jane 18,547.41 ha siperfage e shfrytézuar e tokes bujqêsore, ndersa sipas te dhenave tê nxjerura nga Drejtorati i Bujqésisé nga aplikimi i fermërve per subvencione për vitin 2023 del gé tê mbjellurat vjeshtore dhe pranverore shkojne nê rreth 9100 ha.

Me fillimin e vitit 2024 është bërë Plani i punës, në bazë të të cilit Drejtoria e Bujqësisë do t'i kryejë të gjitha punët dhe aktivitetet e saj.

Ne, si Drejtori e Bujqësisë, përveç planit tonë të punës, kryejmë edhe detyra që dalin nga Ministria e Bujqësisë, e veçanërisht aplikimin e fermerëve për subvencionim, raportimin për realizimin e mbjelljeve të kulturave bujqësore, korrje-shirjeve, ndërrimin e kulturës bujqësore nga toka pyjore në tokë bujqësore (sipas kërkesave të fermerëve), raportimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, organizimin e shërbimeve këshillimore etj.

Në muajin janar, më datë 15.01.2024, ka filluar aplikimi i fermerëve për subvencionim të qumështit, majmëri të viçave dhe therjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, i cili ka zgjatur deri më 13.02.2024.

Duke pasur parasysh se mbjelljet pranverore fillojnë herët në pranverë, ne paraprakisht, si drejtori, kemi përgatitur planin e mbjelljeve pranverore dhe njëkohësisht kemi këshilluar fermerët që t'i aplikojnë të gjitha masat agroteknike, si dhe të përdorin farëra cilësore dhe të certifikuara për mbjellje në mënyrë që të arrihen rendimente sa më të larta.

Këtë plan po e paraqesim edhe në formë tabelore për vitin 2024:

| Nr. | **Kultura** | **Sipërfaqet e planifikuara ha** | **Sipërfaqet e realizuara ha** |
|---|---|---|---|
| 1. | Misër | 2995 | 2990 |
| 2. | Tërshërë | 260 | 255 |
| 3. | Perime | 200 | 145 |
| 4. | Patate | 145 | 150 |
| 5. | Bimë foragjere | 785 | 785 |
| 6. | Të tjera | 85 | 80 |
| | Gjithsej | 4470 | 4405 |

Siç shihet nga tabela, plani i mbjelljeve pranverore është realizuar pothuajse në tërësi me disa ndryshime të vogla sipas kulturave dhe sipërfaqeve të mbjella.

Gjatë kësaj kohe, ne si Drejtori e Bujqësisë vazhdimisht kemi monitoruar procesin e mbjelljeve pranverore dhe kemi këshilluar fermerët t'i përmbahen masave agroteknike.

Më datën 13.03.2024 ka filluar aplikimi për subvencione që mbështeten nga Ministria e Bujqësisë - Agjencioni i Zhvillimit të Bujqësisë së pagesave direkte për sipërfaqe dhe derivate për këto kultura bujqësore: grurë, misër, thekër, tërshërë, elb, lulediell, pemë dru frutor, pemë të imëta, perime, si: spec, domate, patate, lakër, qepë, hudhër, kunguj, bimë aromatike. Po ashtu në blegtori për numër të krerëve, si: lopë qumështore, dele qumështore, dhi qumështore, dosa, bletë, pula vojse.

Me fillimin e aplikimit të subvencioneve, Drejtoria e Bujqësisë paraprakisht i ka njoftuar fermerët për afatin dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim dhe gjatë kësaj periudhe procesi ka shkuar mjaft mirë dhe numri i aplikuesve krahasuar me vitin e kaluar ka qenë më i madh. Duke pasur parasysh afatin shumë të shkurtër për aplikim, ne jemi angazhuar dhe kemi punuar edhe jashtë orarit të punës, në mënyrë që të mos mbetet asnjë fermer pa aplikuar. Afati për aplikim ka zgjatur deri më 29.04.2024. Këtë vitë kanë aplikuar gjithsej 1130 fermerë për të gjitha llojet e subvencioneve.

Para fillimit të korrje-shirjeve është formuar komisioni në nivel komunal për përcjelljen e kësaj fushate. Ky komision, nga fillimi deri në përfundim, ka monitoruar fazën e korrje-shirjeve, inspektimin e autokombajnave për gjendjen teknike të tyre dhe vazhdimisht i kemi këshilluar fermerët që të mos bëjnë djegien e hamulloreve duke pasur parasysh se janë të dëmshme për tokën bujqësore dhe ambientin përreth.

Rendimenti i grurit këtë vit ka qenë shumë i mirë duke marrë parasysh se kushtet klimatike kanë qenë shumë të favorshme dhe nuk është atakuar nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

Më datën 01.08.2024 deri 02.09.2024 është hapur aplikimi për dorëzimin e faturave të plehut, dëshmitë për sasinë e grurit të dorëzuar në pikat grumbulluese si dhe për qumësht dhe viça për majmëri.

Pas përfundimit të aplikacioneve, dokumentacionet e kompletuara edhe në formë fizike i kemi dërguar në MBPZHR për subvencionim përkatësisht në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë.

Për këtë subvencion kanë aplikuar gjithsej 840 fermerë.

Nga Drejtoria e Bujqësisë këtë vit janë realizuar këto projekte :

- Projekti i serrave në sipërfaqe 32 $m^2$ - përfitues 50 fermerë
- Projekti i serrave në sipërfaqe 100 $m^2$ - përfitues 20 fermerë
- Motokultivator- përfitues 50 fermerë
- Freza- përfitues 35 fermerë
- Shpërndarëse të plehut – përfitues 45 fermerë
- Shtrimi i disa rrugëve fushore në Zllakuqan e Krushevë të Madhe
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Grabanicë
- Projekti komunë-Islamik për mekanizëm bujqësor dhe serra- përfitues 400 fermerë

Projektet dhe subvencionet kanë ndikuar në zhvillimin e bujqësisë si dhe rritjen e të ardhurave për ekonomi familjare.

Përpos punëve me palë në zyrë, vazhdimisht ne kemi vizituar fermerët: Lavërtarë, Bletarë, Pemëtarë, Blegtorë, të cilët i kemi mbështetur në dhënien e këshillave në këto fusha, orientimin e tyre për një bujqësi të qëndrueshme dhe të zhvilluar. Po ashtu janë shpërndarë edhe broshura me tema të caktuara në lëmin e bujqësisë.

Drejtoria e Bujqësisë, në bashkëpunim me departamentin e shërbimeve këshillimore në nivel të Ministrisë së Bujqësisë, duke filluar nga fundi i qershorit deri në muajin dhjetor, kemi organizuar trajnime për fermerë me tema të ndryshme si: -Sëmundjet e bletëve

-Të ushqyerit e gjedheve nga ushqimi veror në atë dimëror

-Përdorimi i herbicideve në lavërtari

-Mbrojtja e pemëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të ushqyerit e tyre

- kultivimi i perimeve në serra dhe ambiente të hapura.

Në këto trajnime kanë marrë pjesë mbi 150 fermerë, të cilët kanë shfrytëzuar edhe përvojat praktike.

Për të qenë sa më të suksesshëm dhe për t'u kryer në afat optimal mbjelljet vjeshtore, ne vazhdimisht

kemi këshilluar fermerët që të bëjnë përgatitjen me kohë të sipërfaqeve tokësore, të përdorin farërat cilësore të certifikuara dhe plehrat minerale.

Para fillimit të mbjelljeve vjeshtore, ne si Drejtori e Bujqësisë kemi hartuar planin për mbjelljet vjeshtore të cilin po e paraqesim në formë tabelore për vitin 2024/2025:

| Nr. | **Kultura** | **Sipërfaqet e planifikuara ha** | **Sipërfaqet e realizuara ha** |
|---|---|---|---|
| 1. | Grurë | 4520 | 4470 |
| 2. | Elb | 125 | 120 |
| 3. | Thekër | 65 | 60 |
| 4. | Foragjere | 550 | 560 |
| | Gjithsej | 5260 | 5210 |

Gjatë këtij, viti kushtet klimatike kanë qenë shumë të favorshme për mbjellje, të cilat kanë ndikuar edhe në rritjen e sipërfaqeve të mbjella me kultura vjeshtore.

Ne si Drejtori e Bujqësisë kemi bashkëpunim me Organizatat jo qeveritare dhe me drejtoritë komunale të Bujqësisë së Komunave tjera.

Në kuadër të Festivalit "I Këndojmë Lirisë" kemi organizuar Panairin e Produkteve Bujqësore, në të cilin fermerët e Klinës dhe të Komunave tjera kanë ekspozuar prodhimet e tyre për tri ditë radhazi sa ka zgjatur festivali. Në këtë panair, përveç fermerëve të komunës së Klinës, ka pasur edhe fermerë të Komunave të regjionit që kanë ekspozuar produktet e tyre.

## 21. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM PËR TË ARDHURAT SIPAS FUSHAVE SEKTORIALE NË KOMUNËN E KLINËS

Për çështjet urbane teknike të zbatimit të HZK-së, vlerësimi është prezantuar në pikën 8 të këtij raporti. Të dhënat e ofruara tregojnë për një nivel më të lartë të zbatueshmërisë së HZK-së në fushën e ndërtimeve krahasuar me vitin paraprak raportues.

Sa i përket fushave të tjera sektoriale, vlerësohet se përfshirja e projekteve për realizim është në përputhje me Planin e Veprimit të përcaktuar me Shtojcën I të HZK-së. Në krahasim me të dhënat e prezantuara në këtë raport dhe objektivat e përcaktuara në Planin e Veprimit, vërehet se shumica e projekteve janë realizuar në përputhje me pritshmëritë dhe kapacitetet buxhetore përkatëse.

Për një vlerësim më specifik të këtyre fushave, duhet pasur parasysh se periudha raportuese përfshin dy gjysmëvjeçarë të njëpasnjëshëm, çka e ndërlikon procesin e matjes dhe krahasimit të rezultateve. Kjo është e lidhur drejtpërdrejt me vitet buxhetore, dhe si e tillë, përbën një sfidë në realizimin e një vlerësimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të zbatimit të HZK-së në të gjitha fushat sektoriale.

## 22. RISHQYRTIMI I PËRMBAJTJES DHE PËRMASAVE TË NDRYSHIMEVE, PLOTËSIMEVE, PËRJASHTIMEVE DHE BONUSEVE TË ZONIMIT NË KOMUNËN E KLINËS

Autoriteti përgjegjës për planifikim hapësinor në bashkëpunim me organet kompetente të Komunës së Klinës, gjatë vitit të parë të zbatimit të HZK-së, ka vlerësuar se në këtë dokument duhet bërë disa ndërhyrje në formë të ndryshimeve dhe plotësimeve. Megjithatë, lidhur me këtë, nuk është marrë pëlqimi nga autoriteti përgjegjës qendror.

Në të njëjtën kohë, është konsideruar se ndërhyrjet e mundshme përmes formave të tjera si bonuset apo përjashtimet e veçanta nuk paraqesin zgjidhje të qëndrueshme në parim dhe nuk janë të përputhshme me përmbajtjen thelbësore të disa çështjeve të HZK-së. Këto çështje, në praktikë, janë identifikuar si pengesa të pakapërcyeshme që e vështirësojnë zbatimin efikas të dokumentit në tërësi.

Aktualisht, Komuna e Klinës ndodhet në fazën përfundimtare të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, proces ky i cili është pezulluar përkohësisht për shkak të rrethanave administrative dhe procedurale, të cilat janë të njohura edhe për Kuvendin e Komunës së Klinës. Kjo pezullim ka ndikuar në ngadalësimin e integrimit të plotë të HZK-së me dokumentet e tjera strategjike zhvillimore.

## 23. PËRFUNDIMI

Vlerësojmë se përmes këtij raporti janë ofruar informacione të mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse lidhur me monitorimin e nivelit të zbatimit të HZK-së së Komunës së Klinës për periudhën përkatëse të raportimit.

Megjithatë, është evidente se trajtimi i implikimeve hapësinore që burojnë nga zbatimi i HZK-së mbetet një aspekt kompleks dhe shumëdimensional. Kjo kërkon qasje më të thelluara analitike dhe përfshirjen e ekspertizës së duhur profesionale për të siguruar implementim më të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të këtij dokumenti planifikues.

Ndërtimet me leje janë realizuar kryesisht brenda kufijve të përcaktuar me hartën për shfrytëzimin e tokës, duke respektuar orientimet dhe kriteret e planifikimit hapësinor. Zhvillimet në fushën e ndërtimeve si dhe përparimet në infrastrukturën publike, përbëjnë indikatorë të qartë të avancimit të procesit të zbatimit të HZK-së.

Përmbledhtas, me të dhënat dhe analizat e prezantuara, është pasqyruar gjendja reale dhe janë vënë në pah aspektet themelore të zbatueshmërisë së Hartës Zonale të Komunës së Klinës në vitin e tretë të hyrjes në fuqi të saj.

PRILL 2025

DREJTORIA URBANIZMIT DHE MBROJTJËS SË MJEDISIT

Nr.

KLINË : **KUVENDI I KOMUNËS KLINË**

Kryesuesi i Kuvendi

Fadil Gashi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

*Kuvendi i Komunës Klinë*
*Komiteti për Politikë dhe Financa*
*01Nr* 06 – 11499 */25*
*Klinë:* 22.04 */25*

**PËR: Kuvendin e Komunës Klinë**

**Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa**

**Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi**

**R E K O M A N D I M E T e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës: 07.04.2025**

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e IV-të të rregullt për vitin 2025, shqyrtoi dhe miratoi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend këto pika të rendit të ditës.

**Pika 1. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-mars 2025**

-Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, referoi drejtori nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, ku theksoi se buxheti për vitin 2025 është 16,238,141.93 €, Granti Qeveritar 14,673,149.00 €. Grumbullimi i të hyrave buxhetore gjatë këtij tremujori ka arritur shumën prej 305,247.50 €, Shpenzimet buxhetore në periudhën janar-mars 2025 në shumën prej 4,543,158.98 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2024 në shumën prej 3,082,783.27 € janë më të larta për 47.37 % . Ndikim në rritjen e shpenzimeve ka pasur kategoria e shpenzimeve kapitale (rritje në kryerjen e punëve), kategoria e shpenzimeve komunale (obligime të bartura nga viti 2024) dhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve (pagesat e transportit të nxënësve, pagesat e obligimeve lindje dhe varrime dhe subvencionimi i bujqve).

Buxheti i shpenzuar në periudhën Janar-mars 2025 në shumën prej 4,543,158.98 € është 28.10 % e buxhetit në SIMFK krahasuar me shumën e përgjithshme të buxhetuar për vitin 2025. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 4,364,334.74€ (29.74 % në raport me buxhetin nga granti ), nga të hyrat vetanake janë shpenzuar 167,022.24 € (11.17% në raport me buxhetin nga granti), nga donacionet e brendshme janë shpenzuar 11,802.00 € (24.30% në raport me buxhetin nga granti).

Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 4,543,158.98 € nga granti qeveritar janë shpenzuar 96.06% , nga të hyrat vetanake 3.68% dhe nga donacionet e brendshme 0.269 %. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet për këtë periudhë janë më të larta për 47.37 % po ashtu u kërkua që i njëjti të kaloj për shqyrtim në Kuvend.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Raportit të Menaxhimit Financiar janar-mars 2025, rekomandoi që Raporti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.**

**Pika 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025.**

Gjithashtu, sa i përket kësaj pike, referoi drejtori nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, kërkoi bartjen e mjeteve të pashpenzuara dhe mjetet nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024, dhe bartjen në vitin 2025, gjithsej shumën prej **624,854.99 €.**

Nga shuma e përgjithshme **624,854.99 €,** nga fondi 21 dhe 22 është shuma prej 293,727.28 € dhe nga tejkalimi i planifikimit të të hyrave shuma prej **331,127.71 €.** Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave, Ligjit të Buxhetit për vitin 2025 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet nga viti paraprak sipas kontratave të nënshkruara. Nisur nga kjo, propozimi ynë për shpërndarjen e tyre nëpër programet dhe nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, është si vijon:

- Mallra dhe Shërbime, në shumën prej **90,000.00 €;**
- Shpenzimet komunale, në shumën prej **90,000.00 €;**
- Subvencione dhe transfere, në shumën prej **92,746.95 €;**
- Shpenzime kapitale, në shumën prej **352,108.04 €.**

**<u>Në kategorinë mallra dhe shërbime :</u>**

**Arsimi Parafillor (92550),** shuma prej **7,619.50 €;**

**Arsimi i Mesëm (94710),** shuma prej **11,936.30 €;**

**Administrata (16318),** shuma prej **5,000.00 €;**

**Shërbimet kulturore (85018),** shuma prej **8,000.00 €;**

**Buxhetimi (17518),** shuma prej **57,444.2 €;**

**<u>Në kategorinë e shpenzimeve komunale :</u>**

**Drejtoria për Buxhet e Financa (17518),** shuma prej **50,000.00 €;**

**Administrata e arsimit (92090),** shuma prej **40,000.00 €.**

**<u>Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve</u>**

**Zyra e Kryetarit** (16018), shuma prej **20,000.00;**

**Administrata e arsimit** (92090), shuma prej **2,800.00 €;**

**Shërbimet kulturore (85018), shuma** prej **69,946.95 €.**

**<u>Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:</u>**

**Planifikimi urban dhe inspeksion (66395 ) në projektet:**

"Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Siqevë-Ujmirë-Shtaricë", kodi (54924), shuma prej 20,000.00 €;

"Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Poterq-Dugajevë-Drenoc", kodi (54344), shuma prej 25,000.00 €;

"Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugët Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit, etj", kodi (56059) shuma prej 20,000.00 €;

"Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugët Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj", kodi (56063), shuma prej 20,000.00 €;

"Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore (trotuare) dhe infrastrukturës nëntokësore në Zajm-Deiq", kodi (56074), shuma prej 15,000.00 €;

"Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Volljakë-Sferkë-Qupevë-Dush", kodi (56084), shuma prej 15,000.00 €;

"Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Gjurgjevik i Madh-Dush", kodi (56094), shuma prej 25,000.00 €;

"Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik", kodi (56106), shuma prej 21,000.00 €.

**Bujqësi (47018), në projektet:**

"Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë- Zajm,Poterq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj", kodi (56152), shuma prej 44,698.91 €.

**Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:**

"Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Zllakuqan, Klinë-Videjë, etj", kodi (56126), shuma prej 50,000.00 €;

**Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), në projektet:**

"Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve shëndetësore: QKMF, AMF Drenoc, Ujmirë, Zllakuqan dhe Gllarevë etj", kodi (56149), shuma prej 150.00 €.

**Shërbimet Rezidenciale (75587), në projektet:**

"Ndërtimi i shtëpisë së pleqve në Kline", kodi (54463), shuma prej 15,000.00 €.

**Administrata (16318), në projektet:**

"Blerja e veturave zyrtare për nevoja te Administratës Komunale", kodi (54370), shuma prej 22,290.00 €

**Shërbimet Kulturore (85018), në projektet:**

"Ndërtimi dhe Rindërtimi i Objektit Sportiv dhe të Kulturës në Klinë", kodi (56154), shuma prej 38,969.13 €

**Arsim dhe Shkencë - Administrata (92090), në projektet:**

"Ndërtimi i nxehjeve qendrore me pompa termike dhe nxehje me kaldaja me pelet në shkolla, në gjimnazin "Luigj Gurakuqi", Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik i Madh, Budisalc, Ujmirë, Drenoc (56137), shuma prej 10,000.00 €;

"Ndërtimi i fushave sportive dhe parkingjeve në shkolla në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj", kodi (56147), shuma prej 10,000.00 €.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për bartje e mjeteve te pashpenzuara dhe mjetet nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024, dhe bartjen në vitin 2025, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 3. Shqyrtimi i propozim-vendimeve të kryetarit të komunës për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimeve 01Nr.06-8532/2025 dhe 01Nr.06-8705/2025.**

Propozim-vendimi **01Nr.06-8532/2025**, propozim i dhënë nga Kryetari i Komunës, bazuar në kërkesën e Bashkësisë Islame në Klinë me anë të së cilës kërkojnë financim në vlerë prej **15,000.00** euro për blerjen e një veture e cila do të shërbente për shërbime të cilat kryhen nga BIK.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për ndarje të mjeteve për blerjen e një veture për shërbimet e Bashkësisë Islame në Klinë, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

Propozim-vendimi **01Nr.06-8705/2025**, propozim i dhënë nga Kryetari i Komunës, bazuar në kërkesën e Stacionit Policor në Klinë, me anë të së cilës propozohet ndarja e shumës në vlerë prej 11,000.00 euro me qëllim të plotësimit të nevojave dhe krijimit të kushteve më të mira të Policisë së Kosovës, Stacionit Policor në Klinë.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për ndarje të mjeteve në shumë prej 11,000.00 euro, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 4. Shqyrtimi i propozim-vendimeve të DKA-së për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimeve 01Nr.553-8606/2025 dhe 01Nr.553-8607/2025.**

Propozim-vendimi **01Nr.553-8606/2025**, propozim i dhënë nga DKA, bazuar në kërkesën e parashtruar nga Tuana Camaj për përkrahje financiare lidhur me udhëtimin e nxënëses për pjesëmarrje në Olimpiadën e shkencave që mbahet në Barcelonë nga data 09.07.2025 deri me datën 15.07.2025, shuma e propozuar për ndarje nga DKA në vlerë prej 1500 euro.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të DKA-së për ndarje të mjeteve financiare për nxënësen Tuana Camaj, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, po ashtu në bazë të mundësive buxhetore të rritet vlera e rekomanduar nga DKA.**

Propozim-vendimi **01Nr.553-8607/2025,** propozim i dhënë nga DKA, bazuar në kërkesën e parashtruar nga Klejda Bashota për përkrahje financiare lidhur me udhëtimin e nxënëses për pjesëmarrje në Festivalin IFLC në Gjermani, ku me këtë pjesëmarrje do ta përfaqësojë shkollën. Shuma e propozuar për ndarje nga DKA në vlerë prej 1500 euro.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të DKA-së për ndarje të mjeteve financiare për nxënësen Klejda Bashota, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, po ashtu në bazë të mundësive buxhetore të rritet vlera e rekomanduar nga DKA.**

**Pika 3. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimit 01Nr.644-8473/25.**

Propozim-vendimi 01Nr.644-8473/25 i dhënë nga DKRS për ndarje të mjeteve financiare në shumë prej 30,000.00 euro nga kategoria e subvencioneve në DKRS për mbajtjen e edicionit të 23 të festivalit folklorik "I Këndojmë Lirisë"

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të DKRS-së për ndarje të mjeteve financiare për mbajtjen e festivalit folklorik "I Këndojmë Lirisë" rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2025, raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxhetore në SIMFK**

| Nr. | Kodi ekonoı | Përshkrimi | Shpenzimet Janar-Mars /2025 | Shpenzimet janar- mars /2024 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 11111 | PAGAT NETO PERMES LISTAVE | 1,703,488.15 | 1,523,665.75 | 179,822.40 |
| 2 | 11121 | TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE | 116,026.85 | 116,428.47 | (401.62) |
| 3 | 11131 | KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI | 105,412.34 | 94,985.24 | 10,427.10 |
| 4 | 11151 | SINDIKATAT | 4,497.89 | 3,763.35 | 734.54 |
| 5 | 11152 | ODAT PROFESIONALE | 4,070.38 | 3,451.44 | 618.94 |
| PIKA 5 - PAGESE NGA ANETRAET E ODAVE TE MJEKESEVE, PSIKOLOGEVE, ETJ | | | | | |
| 6 | 11211 | PËRVOJA E PUNËS | 95,055.35 | 82,807.31 | 12,248.04 |
| 7 | 11311 | KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI | 105,412.34 | 94,985.24 | 10,427.10 |
| 8 | 11411 | SHTESA E VEÇANTË PËR TË ZGJEDHURIT | 9,277.54 | 12,348.51 | (3,070.97) |
| PIKA 8 -KJO SHTESE ESHTE PAGESA E KOMITETEVE TE RREGULLTA (KPF, K.I MINORITETEVE DHE K.I AUDITIMIT) | | | | | |
| 9 | 11416 | SHTESA PËR VËLLIMIN E PUNËS | 440.83 | 276.38 | 164.45 |
| PIKA 9 -KJO SHTESE ESHTE PAGESË PËR PUNË MBI NORMË TE CAKTUAR ME MARRVESHJE ZYRTARE | | | | | |
| 10 | 11418 | SHTESA PËR NËPUNËSEN/IN E SISTEMIT SHËNDETËSOR | 2,848.88 | - | 2,848.88 |
| PIKA 10 -KJO SHTESE ESHTE PAGESË PËR STAFIN MJEKESOR (DOKTORET SPECIALIST) TE CILIT NUK PUNOJNE NE INSTITUCIONE PRIVATE | | | | | |
| 11 | 11431 | KUJDESTARIA, PUNA GJATË NATËS & PUNA JASHTË ORARIT TË PUNËS | 74,937.66 | 65,396.83 | 9,540.83 |
| PIKA 11 - ESHTE KOD I RI, NE KETE KOD HYJNE KUJDESTARIA NE SHENDETESI, TEK ZJARRFIKSAT DHE ZEVENDESIMI I PUNETOREVE DERI NE PERFUNDIMIN E REKRUTIMIT | | | | | |
| 12 | 11611 | SHTESAT TRANZITORE | 660.06 | 1,594.16 | (934.10) |
| PIKA 12 - SHTESAT TRANZITORE JANE SHTESAT PER PAGAT E ZVOGELUAR ME LIGJIN E RI TE PAGAVE | | | | | |
| | TOTALI: | RROGAT DHE PAGAT | 2,222,128.27 | 1,999,702.68 | 222,425.59 |
| 13 | 13140 | TRANSPORTI PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT | 310.00 | - | 310.00 |
| 14 | 13141 | PARA XHEPI/MËDITJET PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT | 354.00 | | 354.00 |
| 15 | 13143 | SHPENZIMET E TJERA PËR UDHËTIMET ZYRTARE JASHTË VENDIT | 7.00 | - | 7.00 |
| PIKA 13 DERI 15 - HYJNE PAGESAT E ZYRTAREVE QE UDHETOJNE ZYRTARISHT JASHTE VENDIT | | | | | |
| 16 | 13310 | SHPENZ. PËR INTERNET | 755.41 | 682.78 | 72.63 |
| PIKA 16 -NE KETE KOD REGJISTROHET SHPENZIMI I INTERNETIT NE SHKOLLA, ADMINSTRATA, DHE TEK ZJARRFIKSAT | | | | | |
| 17 | 13320 | SHPENZ.E TELEFONIT-VALA 900 | 3,927.50 | 1,937.22 | 1,990.28 |
| PIKA 17 - REGJISTROHEN SHPENZIMET E TELEFONISE MOBILE, LINJA 3 EURO MBUSHJE PER ZYRTARET | | | | | |
| 18 | 13330 | SHPENZIMET POSTARE | 28.90 | 321.70 | (292.80) |
| PIKA 18 - REGJISTROHEN SHPENZIMET E DERGIMEVE TE DOKUMENTEVE ZYRTARE ME POSTE | | | | | |
| 19 | 13430 | SHËRBIME TË NDRYSHME SHËNDETSORE | 37,568.80 | 34,777.90 | 2,790.90 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| PIKA 19 - REGJISTROHET SHPENZIMI I SHERBIMIT TE EKIPES MJEKESORE - KUJDESI PALIATIV NE SHTEPITE E TE MOSHUARVE | | | | | |
| 20 | 13445 | SHËRBIMET E VEÇANTA - KONSULENTË DHE KONTRAKTORË INDIVIDUAL | 10,459.31 | 15,819.84 | (5,360.53) |
| PIKA 20 - REGJISTROHEN SHPENZIMET E PAGAVE PER PUNETORET E ANGAZHUAR ME PROCEDURA PROKURIMI (MENAXHERET E KONTRATAVE, NJE PUNETOR PER SHERBIME VETERINARE NE BUJQESI DHE PAGESAT E MEDITJEVE PER ANETARET E KKSB-se | | | | | |
| 21 | 13450 | SHËRBIME SHTYPJE - JO MARKETING | 4,273.20 | 1,030.67 | 3,242.53 |
| PIKA 21 -REGJISTROHEN SHPENZIMET E PRINTIMIT, FOTKOPJEVE, SKANIMEVE SIPAS KONTRATES ME AQP | | | | | |
| 22 | 13460 | SHERB.KONTRAKTUESE TJERA | 6,669.50 | 34,149.29 | (27,479.79) |
| PIKA 22 - ESHTE REGJISTRUAR TRAJTIMI DHE KASTRIMI I QENVE ENDACAK, TRANSPORTI I NXENESVE NEPER PUNETORI TE NDRYSHME. ESHTE ME I VOGEL SE NE VITIN 2024 NGASE ENDE NUK ESHTE PAGUAR VIZITA NE ITALI E ANETAREVE TE KUVENDIT DHE STAFIT EKZEKUTIV | | | | | |
| 23 | 13470 | SHERBIME TEKNIKE | 3,894.89 | 12,994.96 | (9,100.07) |
| PIKA 23 - REGJSITROHET ASGJESIMIN E BARNAVE DHE MBETJEVE MJEKSORE, SHERBIME ZERIMI NE PROGRAME TE SHKOLLAVE DHE KULTURORE, DEZINFEKTIMI DDD TE OBJEKTIT TE QERDHES SE FEMIJEVE, ETJ. ESHTE ME I VOGEL NGA VITI 2024 SEPSE NE VITIN 2024 JKA PASUR BORGJE TE BARTURA NE KETE KOD EKONMIK | | | | | |
| 24 | 13475 | SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE PUBLIKE | 8,107.50 | 9,729.00 | (1,621.50) |
| PIKA 24 - REGJSITROHET PAGESA E SIGURIMIT FIZIK TE OBJEKTIT TE SHENDETESISE DHE PALESTRES SPORTIVE | | | | | |
| 25 | 13480 | SHPENZIMET PER ANETARESIM | 5,774.40 | 5,774.40 | - |
| PIKA 25 - REGJISTROHET TARIFA E ANETARESIMIT NE ASOCIACIONIN E KOMUNAVE. | | | | | |
| 26 | 13501 | MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro) | 848.00 | 6,716.00 | (5,868.00) |
| 27 | 13503 | KOMPJUTERËT | - | 5,590.00 | (5,590.00) |
| 28 | 13509 | PAISJE TJERA<1000 EURO | - | 360.00 | (360.00) |
| 29 | 13511 | PAJISJET SPORTIVE | 15,749.40 | - | 15,749.40 |
| PIKA 29 - REGJISTROHEN FURNIZIMET ME PAJISJE SPORTIVE NE SHKOLLA DHE PER AKTIVITETE KULTURORE | | | | | |
| 30 | 13610 | FURNIZIME PER ZYRE | 6,408.01 | 6,496.21 | (88.20) |
| PIKA 30 - REGJISTROHEN FURNIZMET ME MATERIALSHPENZUES PER ZYRE | | | | | |
| 31 | 13611 | FURNIZIMI ME DOKUMENTE BLLANKO | - | 2,000.00 | (2,000.00) |
| PIKA 31 - REGJISTROHEN FURNIZIMET ME CERTIFIKATA (DOKUMENT ZYRTAR I ZBRAZET) | | | | | |
| 32 | 13620 | FURNIZIM USHQIM&PIJE(JO DREKA) | 26,842.40 | 5,323.93 | 21,518.47 |
| PIKA 32 - REGJSITROHEN FURNIZIM ME USHQIM DHE PIJE PER QERDHEN E FEMIJEVE, FURNIZIM ME QUMSHT PER ZJARRFIKAT, PJESA ME E MADHE E KETIJ SHPENZIMI ESHTE PAGESA E PAKETAVE ME ARTIKUJ USHQIMOR PER PUNETORET E ADMINSITRATES KOMUNALE DHE KUVENDIT ME RASTIN E VITIT TE RI | | | | | |
| 33 | 13630 | FURNIZIME MJEKSORE | 26,098.50 | 34,337.59 | (8,239.09) |
| PIKA 33 - REGJISTROHEN FURNIZIMET ME LISTEN ESENCIALE TE BARNAVE, FURNIZIM ME FILMA PER RENTEGEN | | | | | |
| 34 | 13640 | FURNIZIM PASTRIMI | 3,806.15 | 1,706.80 | 2,099.35 |
| PIKA 34 - REGJISTROHEN FURNIZIMET ME MATERIAL HIGJENIK NE SHKOLLA | | | | | |
| 35 | 13720 | NAFT PER NGROHJE QENDRORE | 8,016.30 | 3,994.09 | 4,022.21 |
| PIKA 35 - REGJISTROHET FURNIZIMI ME NAFTE PER NGROHJE TE OBJEKTEVE SHKOLLORE | | | | | |
| 36 | 13760 | DRU | 48,755.60 | 32,654.00 | 16,101.60 |
| PIKA 36 - REGJISTROHET FURNIZIMI ME DRU DHE PELET PER NGROHJE TE OBJEKTEVE SHKOLLORE | | | | | |
| 37 | 13780 | DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATORË DHE MAKINERI | 13,453.27 | 18,919.31 | (5,466.04) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| PIKA 37 - REGJISTROHEN SHPENZIMET E KARBURANTEVE TE VETURAVE ZYRTARE DHE FURNIZIMET ME DERIVATE PER NEVOJA TE SHKOLLAVE | | | | | |
| 38 | 13810 | AVANCË (PARADHËNIA) PËR PARA TË IMËTA | 500.00 | - | 500.00 |
| PIKA 38 - REGJISTROHET PARAJA E IMET PER SHPENZIME DERI NE 100 EURO, I HAPUR DERI NE FUND TE VITIT FISKAL. | | | | | |
| 39 | 13820 | AVANC PËR UDHËTIME ZYRTARE | 2,552.80 | - | 2,552.80 |
| PIKA 39 - REGJISTROHEN PAGESAT E UDHETIMEVE ZYRTYARE JASHTE VENDIT | | | | | |
| 40 | 13950 | REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE | 1,165.00 | 810.00 | 355.00 |
| 41 | 13951 | REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE | 2,000.46 | 1,998.16 | 2.30 |
| 42 | 13954 | KONTROLLIMI TEKNIK I AUTOMJETEVE | 240.00 | 90.00 | 150.00 |
| PIKA 40 DERI 42 - REGJISTROHEN TARIFAT PER REGJISTRIMIN E AUTOMJETEVE ZYRTARE | | | | | |
| 43 | 14010 | MIREMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE | 8,258.02 | 14,168.90 | (5,910.88) |
| PIKA 43 - REGJISTROHETSERVISIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE | | | | | |
| 44 | 14022 | MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ADMINISTRATIVE DHE AFARISTE | 14,941.80 | 11,474.52 | 3,467.28 |
| PIKA 44 - REGJISTROHEN SHPENZIMET E PASTRIMIT TE OBJEKTEVE ADMINISTRATIVE (OBJEKTI KOMUNAL, OBJEKTI I QPS, OBJEKTI I SHTEPISE SE KULTURES, STACIONI I AUTOBUSAVE) | | | | | |
| 45 | 14023 | MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ARSIMORE | 47,400.82 | 39,141.65 | 8,259.17 |
| PIKA 45 - ESHTE REGJISTRUAR PJESA ME E MADHE BORGJ I BARTUAR PER LYERJEN DHE RENOVIMET NE SHKOLLA, FURNIZIM ME MATERIAL TE IMET PER RENOVIME, PASTRIMI I NE DISA OBJEKTE SHKOLLRE | | | | | |
| 46 | 14024 | MIRËMBAJTJA OBJEKTEVE SHËNDETËSORE | 17,654.54 | 13,535.90 | 4,118.64 |
| PIKA 46 - REGJISTROHET PASTRIMI I HAPESIRAVE TE JASHTME DHE TE BRENDSHME TE OBJEKTEVE SHENDETESORE DHE FURNIZIMET ME MATERIAL TE IMET PER RENOVIME NE OBJEKTET SHENDETESORE, ESHTE ME E MADHE NGASE KEMI PERFIRJE ME TE MADHE TE SIPERFAQES NE KONTRATE | | | | | |
| 47 | 14026 | MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SPORTIVE | 1,853.00 | - | 1,853.00 |
| PIKA 47 - REGJISTROHET MIREMBAJTJA HIGJENIKE E PALESTRES SPORTIVE, VITIN E KALUAR KY SHPENZIM ESHTE REGJISTRUAR NE KODIN 14022 | | | | | |
| 48 | 14032 | MIRMBAJTJA ERRUGEVE LOKALE | 75,183.92 | 94,855.40 | (19,671.48) |
| PIKA 48 - REGJISTROHET ÇDO MIREMBAJTJE QE KA TE BEJE ME RRUGET LOKALE (FURNIZIM ME ZHAVOR PER RIPARIM TE RRUGEVE LOKALE DHE FUSHORE, MIREMBAJTJA E NDRIQIMIT PUBLIK NE QYTET DHE FSHATRA, PASTRIMI I RRUGEVE TE QYTETIT SIPAS MARREVESHJES PER SHERBIME PRIMARE TE MENAXHIMIT TE MBETURINAVE, ETJ.) | | | | | |
| 49 | 14040 | MIRMB.TEKNO.INFORMATIVE | 5,518.86 | 820.00 | 4,698.86 |
| PIKA 49 - REGJISTROHET SERVISIMI I KOMPJUTEREVE DHE MIREMBAJTJA E KAMERAVE | | | | | |
| 50 | 14050 | MIRMB.PAISJEVE DHE MOBILEVE | 39,602.21 | 9,155.60 | 30,446.61 |
| PIKA 50 - REGJISTROHEN SERVISIMET E NXEMJEVE QENDRORE, MIRMBAJTJA DHE SREVISIMI I PAISJEVE-RTG, SERVISIMET DHE MBUSHJA E APARATEVE ZJARREFIKSE NE SHKOLLA, SHENDETSI DHE OBJEKTE TJERA KOMUNALE. NE KETE SHPENZIM PJESA ME E MADHE ESHTE SERVISIMI I NXEMJEVE QENDRORE NE SHKOLLA. | | | | | |
| 51 | 14060 | MIRËMBAJTJA RUTINORE | - | 2,288.00 | (2,288.00) |
| 52 | 14210 | REKLAMAT DHE KONKURSET | - | 850.00 | (850.00) |
| 53 | 14230 | SHPENZIMET PËR INFORMIM PUBLIK | 1,102.70 | 1,247.50 | (144.80) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| PIKA 53 -REGJISTROHET TRANSMETIMI I SEANCAVE TE ASMABLESE DHE TAKIMEVE TJERA ZYRTARE | | | | | |
| 54 | 14310 | KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDA VENDIT | 696.34 | 449.10 | 247.24 |
| PIKA 54 - REGJISTROHEN SHPENZIMET E DREKAVE ZYRTARE | | | | | |
| | TOTALI: 1 | MALLRA DHE SHERBIME | 450,778.51 | 426,200.42 | 24,578.09 |
| 55 | 13210 | RRYMA | 134,555.87 | 73,072.09 | 61,483.78 |
| PIKA 55 - SHPENZIMET ME ENERGJINE, SHPENZIMI ESHTE ME I MADH PER ARSYE TE ZGJERIMIT TE RRJETIT TE NDRIQIMIT PUBLIK DHE DISA SHKOLLA, OBJEKTI KOMUNAL, OBJEKTI I SHENDETESISE KANE KALUAR ME NXEMJE QENDRORE ME POMPA TERMIKE | | | | | |
| 56 | 13220 | UJI | 14,716.92 | 3,706.41 | 11,010.51 |
| PIKA 56 - REGJISTROHEN SHPENZIMET E UJIT DHE KANALIZIMIT, SHPENZIMI ESHTE ME I ADH NGASE KEMI BORGJE TE BARTURA NGA VITI 2024 | | | | | |
| 57 | 13230 | MBETURINAT | 40,356.15 | 12,827.47 | 27,528.68 |
| PIKA 57 - REGJISTROHEN SHPENZIMET E MBETURINAVE, SHPENZIMI ESHTE ME I ADH NGASE KEMI BORGJE TE BARTURA NGA VITI 2024 | | | | | |
| 58 | 13250 | SHPENZIMET TELEFONIKE | 1,268.24 | 1,295.10 | (26.86) |
| PIKA 58 - REGJISTROHEN SHPENZIMET E NUMRAVE FIKS | | | | | |
| | TOTALI: 1 | SHPENZIMET KOMUNALE | 190,897.18 | 90,901.07 | 99,996.11 |
| 59 | 22202 | TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË | 125,638.44 | 110,964.43 | 14,674.01 |
| PIKA 59 - REGJISTROHEN TE GJITHA PAGESAT E SUBVENCIONIMIT PER NDERTIMIN E SHTEPIVE PER SKAMNOR NE BASHKEFINANCIM ME JETIMAT E BALLKANIT, SUBVENCIONIMI PER LINDJE, VARRIME, PERKRAHJEN E BUJQEVE, BURSAT E STUDENTAVE, AKTIVITET KULTURORE KUR NUK JANE OJQ ETJ | | | | | |
| 60 | 22300 | VENDIMET GJYQËSORE | 89,946.95 | - | 89,946.95 |
| PIKA 60 - JANE REGJISTRUAR PAGESAT ME PERMBARIM E OBLIGIMEVE TE DALA NGA KONTRATA KOLEKTIVE E ARSIMIT | | | | | |
| | TOTALI: | SUBVENCIONET DHE TRANSFERET | 215,585.39 | 110,964.43 | 104,620.96 |
| 61 | 31110 | NDËRTESAT E BANIMIT | 164,800.20 | - | 164,800.20 |
| PIKA 61 - ESHTE REGJISTRUAR NDERTIMI I SHTEPISE PER TE MOSHUAR | | | | | |
| 62 | 31121 | OBJEKTET ARSIMORE | 11,895.58 | 2,995.00 | 8,900.58 |
| PIKA 62 - JANE REGJISTRUAR RENOVIMET (RINDERTIMET) NE SHKOLLA SI RENOVIMI I GJIMNAZIT LUIGJ GURAKUQI ETJ | | | | | |
| 63 | 31123 | OBJEKTET KULTURORE | 48,913.83 | - | 48,913.83 |
| PIKA 63 - ESHTE REGJISTRUAR RENOVIMI (RINDERTIMI) I OBJEKTEVE TE KULTURES | | | | | |
| 64 | 31126 | RRETHOJAT | 99,940.00 | | 99,940.00 |
| PIKA 64 - JANE REGJISTRUAR RRETHOJAT E VARREZAVE NE FSHATRA | | | | | |
| 65 | 31230 | NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE | 633,112.45 | 253,523.12 | 379,589.33 |
| PIKA 65 - REGJISTROHET REALIZIMI I PROJEKTEVE NDERTIMI DHE RINDERTIMITI INFRASTRUKTURES MBITOKESORE DHE NENTOKESORE NE FSHATRAT DHE RRUGET E QYTETIT TE KLINES. SHPENZIMI ESHTE ME I MADHE SEPSE KEMI PASUR KONTRATA TE LIDHURA DHE NUK KEMI PASUR VONESA NE REALIZIMIN E KONTRATAVE. | | | | | |
| 66 | 31240 | TROTUARET | 81,863.35 | 48,496.55 | 33,366.80 |
| PIKA 66 - REGJISTROHET REALIZIMI I PROJEKTEVE NDERTIMI TROTUAREVE SIPAS PROJEKTEVE. SHPENZIMI ESHTE ME I MADHE SEPSE KEMI PASUR KONTRATA TE LIDHURA DHE NUK KEMI PASUR VONESA NE REALIZIMIN E KONTRATAVE. | | | | | |
| 67 | 31250 | RRJETET E KANALIZIMIT | 50,820.28 | | 50,820.28 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| PIKA 67 - JANE REGJISTRUAR SHPENZIMET NDERTIMI I KANALIZIMIT NE GLLAREVE-RIXHEVE-STAPANICE-ZABERGJE; SHTYPEL-KERRNICE-BINXHE -GRABC; NE QESKOVE-KPUZE-RASTOKA; NE RANOC -LESKOC, GJURGJEVIK TE MADH; GJURGJEVIK I VOGEL-KLINAVC | | | | | |
| 68 | 31260 | RRJETET E UJESJELLESIT | - | 50,000.00 | (50,000.00) |
| 69 | 31510 | PAJISJET E GJENERIMIT TË EN. ELEK.DHE NDRIÇIMIT PUBLIK | 159,074.99 | - | 159,074.99 |
| PIKA 69 - JANE REGJISTRUAR SHPENZIMET NDERTIMI I RRJETIT TE NDRIQIMIT JASHANICE-JELLOC ETJ.SI DHE NDERTIMI I SHTIGJEVE TE ECJES NE GRYKEN E JARINES -POGRAGJE-JASHANICE; KRUSHEVE E VOGEL,DRENOC,QESKOVE,JASHANICE,LESKOC,RANOC; SHTEGUT TE BICIKLETAVE ME INFRAS.PERCJELLESE-NGA QYTETI DERI TE UDHEKQYQI PEJE-PRISHTINE; | | | | | |
| 70 | 32110 | SHTRETËRIT E LUMENJVE | - | 100,000.00 | (100,000.00) |
| 71 | 32111 | SISTEMET E UJITJES | 30,000.00 | - | 30,000.00 |
| PIKA 71 - JANE REGJISTRUAR NDERTIMI I KANALEVE TE UJITJES BUDISALC-RADULLOC-POTERQ-DOLLOVE FAZA E II | | | | | |
| 72 | 32140 | PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE | 6,515.00 | | 6,515.00 |
| PIKA 72 - REGJISTROHEN SHPENZIMI I NDERTIMI I HAPESIRAVE TE GJELBERTA NE KLINE | | | | | |
| 73 | 34000 | PAGESAT SIPAS VENDIMEVE GJYQËSORE | 176,833.95 | | 176,833.95 |
| PIKA 73 - JANE REGJISTRUAR PAGESAT ME PERMBARIME E OBLIGIMET TE DALA NGA KONTRATA KOLEKTIVE E ARSIMIT | | | | | |
| | TOTALI: | PASURIT JO FINANCIARE | 1,463,769.63 | 455,014.67 | 1,008,754.96 |
| TOTALI I PERGJITHSHEM:11,13,14,20,30 | | | 4,543,158.98 | 3,082,783.27 | 1,460,375.71 |